

LIGJ
Nr.9987, datë 15.9.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI – ISH-
REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË, PËR VITIN 2007, NËN INSTRUMENTIN E
NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA), KOMPONENTI II - BASHKËPUNIMI
NDËRKUFITAR, SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin ndërkufitar Shqipëri – ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, për vitin 2007, nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit (IPA), komponenti II - bashkëpunimi ndërkufitar, Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5895, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN NDËRKUFITAR,
NDËRMJET ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË PËR
VITIN 2007, NËN INSTRUMENTIN E ASISTENCËS SË PARAADERIMIT (IPA) KOMPONENTI
II- BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR SHQIPËRI**

datë
(Menaxhimi i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si "Palët", ose individualisht si "Vendi përfitues", në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit të
duke pasur parasysh se:

a) Në 1 gusht 2006 Këshilli i Bashkimit European vendosi me anë të rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të asistencës për paraaderimin (këtej e tutje: "Rregullorja kuadër IPA"). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet candidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet candidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për tu bërë një ditë anëtare të Bashkimit Evropian.

b) Në 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje: "Rregullorja e zbatimit IPA").

c) Asistenca komunitare, nën instrumentin e asistencës për paraaderim, duhet të vazhdojë të mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural.

d) Palët kanë nënshkruar në 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën instrumentin e paraaderimit.

e) Në datë 10 dhjetor 2007 Komisioni miratoi programin ndërkufitar ndërmjet ish- Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë nën komponentin për bashkëpunimin kufitar IPA për 2007 (këtej e tutje: "programi"). Ky program do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar.

f) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë.

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. Programi

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: 2007/019-361 (CRIS)

Titulli: Programi ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA për vitin 2007.

2. Zbatimi i programit

1) Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të 13 dhjetorit 2006 (këtej e tutje: "Rregullorja financiare").

2) Programi do të zbatohet në përputhje me rregullat e Marrëveshjes kuadër mbi rregullat e bashkëpunimit që lidhen me asistencën financiare të BE-së në Shqipëri dhe zbatimimin e asistencës në kuadër të instrumentit të paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet Palëve në 18 tetor 2007 (këtej e tutje: "Marrëveshja kuadër"), e cila është përcaktuar në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. Strukturat dhe autoritetet përgjegjëse

1) Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar të IPA në përputhje me Marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së për paraaderim nën instrumentin IPA.

2) Koordinator kombëtar i IPA-s do të jetë gjithashtu përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet e baseneve detare, nën instrumente të tjerë të Komunitetit.

3) Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese për pjesën e programit në territorin e vet. Kjo strukturë operationale duhet të bashkëpunojë ngushtë për gjatë implementimit të këtij programi me strukturën operationale të vendit tjetër pjesëmarrës.

4) Sipas nenit 142 të rregullores së zbatimit IPA, strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse duhet të ngrejë një Sekretariat të Përbashkët Teknik për të asistuar strukturat operationale dhe Komitetin e Përbashkët Monitorues në përmbushjen e detyrave të tyre respektive.

Sekretariati i Përbashkët Teknik mund të ketë Antene të ngritur në secilin vend pjesëmarrës.

5) Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave operuese do të përcaktohen në programet ndërkufitare përkatëse, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit, dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Financimi

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2007 është përcaktuar në një maksimum prej € 1,100,000, siç detajohet në shtojcën A1 të aneksit A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostoja e strukturave dhe autoriteve të ngritura nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi do të mbulohet nga Përfituesi, me përjashtim të shpenzimeve referuar në nenin 94(1)(f) të rregullores së zbatimit IPA.

5. Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave

1) Kontratat dhe marrëveshjet individuale të cilat zbatojnë këtë Marrëveshjeje do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2) Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2) Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. Afati për ekzekutimin e kontratave

1) Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2) Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i zbatimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. Afati i disbursimit

1) Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data përfundimtare e ekzekutimit të kontratave.

2) Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet para datës së përfundimit të saj.

8. Trajtimi i fitimeve

1) Fitimi, në kuadër të IPA-s përfshin të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose të ardhura të tjera ekuivalente me përjashtim të:

a) fitimeve të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimeve në firma;

b) fitimeve të nxjerra brenda kuadrit të një mase financiare teknike, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2) Fitimet siç përkufizohen në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhurat të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme përkatëse për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionalisht, në varësi të faktit nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. Shpenzimet e lejueshme

1) Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2) Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH);

b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;

c) blerjet, dhënit me qira ose me kredi të truallit dhe godinave ekzistuese;

- d) gjrobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
 - e) kostot operacionale;
 - f) pajisje të dorës së dytë;
 - g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
 - h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;
 - i) kontribute në natyrë;
 - j) interesa mbi borxhe.
- 3) Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:
- a) taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyrë;
 - ii) është përcaktuar që ato mbulohen nga përfituesi i fundit; dhe
 - iii) janë të identifikuar qartë në projektpropozim;
 - b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;
 - b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;
 - c) në rast se zbatimi i një operacioni kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;
 - d) kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me operacionin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;
 - e) kostot e garancisë të siguruar nga një banke ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit;
 - f) shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25 % të atyre kostove direkte të një aktiviteti i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Për llogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht;
 - g) blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.
- 4) Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritete publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:
- a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi i fundit gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti.
 - b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht ose direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar.
- Autoritetet publike respektive duhet ose t'ia ngarkojnë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve të fundit ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.
- Kostot e referuara në pikën (b) të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë veprim.
- 5) Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin ndërkufitar në aneksin A të kësaj Marrëveshje.
10. Ruajtja e dokumenteve
- 1) Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Evropian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.
 - 2) Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.
11. Plani për decentralizimin pa kontrolle *ex-ante*

1) Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa treguese dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan tregues për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni.

2) Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1, dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante*.

3) Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. Interpretimi

1) Në rastet kur një dispozitë konkrete e kësaj marrëveshje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të mbajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2) Në rastet kur një dispozitë konkrete e kësaj marrëveshje shprehet ndryshe, referencat e kësaj Marrëveshje do të jenë referencat e kësaj Marrëveshje, të ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar here pas here.

3) Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të transpozohen në këtë Marrëveshje me ane të amendimeve.

4) Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

13. Pavlefshëmira e pjesshme dhe të metat e paqëllimshme

1) Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet i pavlefshëm ose kjo Marrëveshje përmban të meta të paqëllimta, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2) Palët do të plotësojnë çdo të metë të paqëllimtë nëpërmjet një dispozite të cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. Rishikimi dhe amendimi

1) Zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord ndërmjet Palëve.

2) Çdo amendim për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve, do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Amendime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet Palëve.

15. Përfundimi

1) Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2) Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë duke informuar me shkrim Palën tjetër. Ky përfundim hyn në veprim gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1) Mosmarrëveshjet e ngritura nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen miqësisht nëpërmjet konsultimit mes Palëve.

2) Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila Palë mund ta çojë çështjen për gjykim në arbitrazh në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme për Arbitrazh që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3) Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë anglishtja. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga cilado nga Palët. Vendimi i Arbitrit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelaues.

17. Njoftime

1) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet në formë të shkruar dhe në

gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:
z.Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit
Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri
Rruga e Durrësit 127-1
Laparakë-Tiranë
Fax: + 355 4230752

Për Vendin Përfitues:
znj. Majlinda Bregu
Ministër i Integritetit
Rruga "Lek Dukagjini", nr.3
P.O. Box 8302
Tiranë, Shqipëri
Fax +355 4256267

18. Gjuha

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. Shtojcat

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e dytë.

Firmosur, për dhe në emër të Komisionit
Z. Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit të Komisionit European
Tiranë
Datë:

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të
Ministrave të Republikës së Shqipërisë nga
Znj. Majlinda Bregu
Ministër i Integritetit
Tiranë
Datë:

Aneksi A. Programi ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë nën komponentin IPA, bashkëpunimi ndërkufitar për vitin 2007, aprovuar me vendimin e Komisionit C(2007)5995

Shtojca A1. Propozimi financiar për vitin 2007 të programit ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Shqipëri

Shtojca A2. Programi ndërkufitar 2007-2013 IPA CBC–Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë–Shqipëri

Aneksi B. Marrëveshja kuadër ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë datë 18 tetor 2007.

Aneksi B

Marrëveshja kuadër midis Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave më datë 3.10.2007 me vendimin nr.642 dhe është firmosur më datë 18.10.2007 nga Ministri i Integritetit dhe Kryetari i Delegacionit të Komisionit të Komuniteteve Evropiane në Tiranë. Kopja origjinale e marrëveshjes i është dërguar Ministrisë së Punëve Jashtme në datën 24.10.2007, me shkresën me nr.prot. 1710 dhe është ratifikuar nga Parlamenti në datën 10.12.2007 me ligjin nr.9840.

Aneksi C: Raportimi

1) Struktura operuese të vendeve përfituese në një program ndërkufitar duhet t'i dërgojë Komisionit dhe koordinatorëve kombëtarë respektivë të IPA-s një raport vjetor dhe një raport final mbi zbatimin e programit ndërkufitar pas kontrollit të tyre nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason miratimin e programit ndërkufitar.

Raporti final duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi

2) Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) progresin e bërë gjatë zbatimit të programit ndërkufitar dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike, të verifikueshme, me një përcaktim sasior të tyre, kurdo dhe kudo që kjo të jetë e mundur

duke përdorur treguesit në nenin 94 (1) (d) të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akteve prioritare;

b) hapat e ndërmarrë nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave,
- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo masë të marrë;
- përdorimin e asistencës teknike;

c) masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat (a) deri në (c) të këtij paragrafi mund të jepen në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën (b) të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

SHTOJCA A1
PROPOZIMI FINANCIAR PËR VITIN 2007

I. PROGRAMIT NDËRKUFITAR: ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË-SHQIPËRI

1. Identifikimi

Përfituesit	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Shqipëria
Numri CRIS	2007/019-361
Viti	2007
Kostoja	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: € 2.2 milionë Shqipëria: € 1.1 milion Vlera totale e kontributit IPA: € 3.3 milion
Strukturat operacionale	Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: dhe Ministria e Vetëqeverisjes Lokale Në Shqipëri: Ministria e Integrimit Europian
Autoritete implementuese	Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Komisioni Europian Për Shqipërinë: Komisioni Europian
Data e fundit për miratimin e marrëveshjes së financimit	Jo më vonë se 31 dhjetor 2008
Datat finale për nënshkrimin e kontratës	2 vjet pas datës së miratimit të Marrëveshjes së financimit; Nuk ka afate për projektet e auditimit dhe vlerësimit të mbuluara nga kjo Marrëveshje financiare, sipas nenit 166(2) të rregullores financiare Këto data aplikohen gjithashtu edhe për bashkëfinancimin kombëtar

Datat finale për ekzekutim	2 vjet nga data e nënshkrimit të kontratë; Këto data aplikohen gjithashtu edhe për bashkëfinancimin kombëtar
Kodi sektorial	16110, 41010, 15050
Linja (t) buxhetore përkatëse	22.02.04.01
Menaxheri mbikëqyrës për programimin	Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: sektori ELARG.B2 Për Shqipërinë: sektori ELARG.C1
Menaxheri mbikëqyrës i zbatimit	Për Shqipërinë: seksionet operacionale, Delegacioni i Komisionit European në Tiranë Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Delegacioni i Komisionit European në Shkup

2. Përmbledhje

2.1 Hyrje

Lidhja me MIPD: Referencat strategjike të programit janë dokumentet e planifikimit indikativ shumëvjeçar (DPISH-MIPD) 2007-2009. Ashtu siç thekson DPISH i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, duke pasur parasysh statusin kandidat të vendit, bashkëpunimin ndërkufitar, ka për qëllim ndër të tjera familjarizimin e vendeve anëtare të ardhshme me rregullat dhe procedurat që udhëheqin qëllimin e bashkëpunimit territorial european në kuadër të fondeve strukturore.

Ai para se gjithash përqendrohet në krijimin e lidhjeve midis rajoneve kufitare, duke mbështetur mbrojtjen e përbashkët të ambientit dhe përmirësimin e potencialeve të turizmit. Këto janë prioritetet dhe objektivat kryesorë të cilat kanë udhëhequr përgatitjen e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor. Në DPISH 2007-2009 alokimet e fondeve të bashkëpunimit ndërkufitar për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë fondet e parashikuara për pjesëmarrjen në programet transnacionale ERDF, u grupuan nën të njëjtin zë. Vendeve përfituese iu kërkuar të vendosnin vetë për planifikimin e alokimit të fondeve për secilin kufi. Në fund të prillit 2007, për shkak të pamundësisë për të përcaktuar një strategji për 2007-2009 ndërmjet Kosovës UNSCR 1244 dhe vendeve të saj fqinje, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë vendosi t'i rialokojë fondet të cilat ishin planifikuar për këtë kufi në 2007 në kufirin shqiptar dhe të jepte 453,020 € për pjesëmarrje në programet transnacionale ERDF. Kjo shpjegon mospërputhjen ndërmjet alokimit për vitin 2007 dhe vitet e tjera dhe gjithashtu mospërputhjen me Shqipërinë ku vendimi që u mor ishte i ndryshëm dhe ku 500,000 € nga fondet e komponentit II i IPA-s për 2007 u alokuan për të financuar një program zhvillimi kufitar të njëanshëm në qarkun kufitar me Kosovën në atë të Kukësit.

- Procesi i programimit

Procesi i programimit u zhvillua në periudhën dhjetor 2006 dhe maj 2007 dhe u mbështet në të dy vendet nga projekti “Ndërtimi institucional ndërkufitar” (Cross-border Institution Building-CBIB). Në secilin vend ai u koordinua nga koordinatorët respektivë për bashkëpunimin ndërkufitar (Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Minsitria e Integritimit European në Shqipëri).

Në dhjetor 2006/janar 2007 secili vend ngriti një grup operacional (OT) që kishte për detyrë përgatitjen e programit ndërkufitar. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ky grup përbëhej nga 11 përfaqësues (ministritë sektoriale, agjencitë shtetërore dhe përfaqësues të përfituesve përfundimtarë) dhe në Shqipëri ky grup përbëhej nga 6 anëtarë. Komiteti i përbashkët i programimit, i ngritur në janar 2007 përbëhej nga anëtarë të grupeve operacionale.

U mbajtën dy takime bilaterale për të përcaktuar planin e veprimit dhe një metodologji të përbashkët për analizën e rajonit ndërkufitar (në Tiranë në 18 dhjetor 2006 dhe në Beograd në 6 shkurt 2007).

Hapat e ndryshëm të programit ndërkufitar (situata dhe analiza SWOT, objektivat dhe strategjia, rregullat e zbatimit) iu prezantuan grupeve operacionale dhe u komentuan gjatë takimeve të

organizuara pothuajse çdo muaj në secilin vend. Këto takime u ndoqën gjithashtu nga përfaqësues të Komisionit European (EAR, DKE). Gjatë kësaj periudhe komiteti i përbashkët i programimit u takua dy herë, një herë në Ohër në 12 prill (miratimi i rajonit të përfituesit dhe prezantimi i situatës dhe analizës SWOT) dhe një herë në Korçë në 23 maj (miratimi i draftit final të dokumentit).

Në 11 maj u organizua një takim në Kicevo, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me qëllim prezantimin e draftit të programit ndërkufitar për përfituesit finale dhe për të diskutuar strategjinë.

- Lista e zonave përfituese

Zona përfituese në ish-Republikën-Jugosllave të Maqedonisë përfshin tri rajone statistikore që i korrespondojnë klasifikimit NUTS III: Pelagonia, Jugperëndimi dhe Polog.

Zona përfituese në Shqipëri përfshin tri rajone administrative që i korrespondojnë klasifikimit NUTS III: qarqet Dibër, Elbasan dhe Korçë.

Territori i zonave të lejuara është pothuajse i njëjtë në secilin vend dhe popullsia është e mirëbalancuar. Megjithatë, analiza e rajonit ndërkufitar zbuloi diferenca të mëdha ndërmjet dy vendeve dhe madje më të mëdha ndërmjet pjesës jugore dhe veriore të rajonit, tiparet demografike dhe tendencat ekonomike janë të ndryshme dhe ndonjëherë kontradiktore. Këto mospërputhje u morën parasysh gjatë përcaktimit të strategjisë së programit.

2.2 Objektivat e përgjithshëm të programit

Objekti i përgjithshëm i programit është “Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në zonën ndërkufitare”. Aksionet dhe projektet ndërkufitare të përbashkëta të zbatuara në kuadër të programit duhet të kenë një ndikim në situatën socio-ekonomike të popullatës, të përmirësojnë menaxhimin e përbashkët dhe vlerësimin e burimeve njerëzore, natyrore dhe kulturore dhe të forcojnë imazhin dhe kohezionin e rajoneve dhe nënrajoneve ndërkufitare.

Janë përcaktuar tre objektiva specifike:

Objekti specifik 1: Të mbështesë ngritjen e aksioneve dhe strategjive të përbashkëta që kanë për qëllim mbrojtjen dhe vlerësimin e burimeve natyrore të rajonit.

Objekti specifik 2: Të forcojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të rajonit.

Objekti specifik 3 është një objektivi i tërthortë: Të zhvillojë partneritete afatgjata dhe rrjete ndërmjet organizatave të shoqërisë civile (OJF, organizatave sportive etj.), organizatave të specializuara (dhoma tregtie, organizata të sipërmarrësve dhe fermerëve) dhe institucione të decentralizuara, në veçanti shkolla dhe fakultete, duke përfshirë njësitë e kërkimit dhe të zhvillimit.

2.3 Akset prioritare, masat e tyre dhe aspektet e tyre specifike në lidhje me zbatimin e buxhetit 2007

Prioriteti 1: Forcimi i zhvillimit ndërkufitar, ekonomik, mjedisor dhe social

Ky prioritet është një përgjigje ndaj situatave të ndryshme dhe ndonjëherë kontrastuese dhe ndaj nevojave për t'u identifikuar brenda rajonit ndërkufitar. Mbrojtja dhe menaxhimi i burimeve natyrore janë konsideruar si çështje ndërkufitare në pjesën jugore (liqenet e Ohrit dhe Prespës), ndërsa çështjet sociale të lidhura me varfërinë dhe papunësinë janë konsideruar si një prioritet parësor në veri. Prioriteti i parë përpiqet të bashkojë këto dy drejtime. Ai gjithashtu përpiqet t'i lërë hapësirë aktorëve ekonomike, në veçanti, por jo vetëm, në sektorin e turizmit, i cili merr parasysh nivelin e ulët të bashkëpunimit të biznesit në kufi. Në mënyrë me të përgjithshme, ky prioritet duhet të lejojë përcaktimin dhe zbatimin e aksioneve “njerëzit për njerëzit” dhe kështu të forcojë bashkëpunimin ndërkufitar në nivelet e komunitetit dhe të shoqërisë civile.

Masa 1: Zhvillimi ekonomik me theks në zonat e lidhura me turizmin

Turizmi është një nga potencialet kryesore ekonomike të rajonit dhe në disa zona ai është tashmë i zhvilluar, pothuajse si një industri. Kjo masë ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e infrastrukturave të vogla, praktikave më të mira dhe planet strategjike me qëllim që të zgjerojë aktivitetet turistike në të gjithë zonën ndërkufitare. Vëmendje e veçantë i është dhënë transferimit të njohurive nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në Shqipëri, ku turizmi është ende në fazë fillestare. Kjo masë i jep prioritet llojeve alternative të turizmit (turizmit rural dhe familjar, eko-turizmit etj.) që ato të mund të zhvillohen paralelisht në praktika me klasike. Në përgjithësi kjo masë ka për qëllim forcimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë që kontribuojnë për ndërtimin e një identiteti të fortë dhe të veçantë në rajonin ndërkufitar. Kjo përfshin promovimin dhe mbrojtjen (përcaktimi i

markës, lidhje më të mirë me tregun) e ushqimit tradicional dhe produkteve bujqësore, si dhe të punimeve artizanale. Si një objektiv i tërthortë dhe me qëllimin që t'i ofrojë komunitetit të biznesit mundësinë për të marrë pjesë në programin ndërkufitar, kjo masë synon gjithashtu lehtësimin e bashkëpunimit të biznesit transkufitar (si p.sh. organizimin e panairëve, studimeve për konsumatorët etj.)

Masa 2: Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor me një theks në mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe eko-sistemeve

Kjo masë ka për qëllim të zhvillojë më tej dinamikën ndërkufitare të filluar në sektorin mjedisor gjatë viteve të fundit. Ajo do të mbështesë përpjekjet e deritanishme të autoriteteve lokale dhe kombëtare për hartimin e politikave mjedisore të përbashkëta dhe programeve pilot dhe do të përfshijë në proces dhe shoqërinë civile. Ajo do të marrë në konsideratë rëndësinë themelore të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore për zhvillimin ekonomik të rajonit.

Masa 3: Kohezioni social dhe shkëmbimi kulturor ndërmjet veprimeve “njerëzit për njerëzit” dhe “institucionet për institucionet”

Duke u bazuar në faktin që bashkëpunimi ndërkufitar është ende në nivel të ulët, masa e tretë ka për qëllim specifik të promovojë aktivitetet “njerëzit për njerëzit” dhe “institucionet për institucionet” (si p.sh. shkolla, universitete, qendra kërkimore). Sektorët prioritarë janë vlerësimi i trashëgimisë unike historike dhe kulturore dhe gjithë llojet e aktiviteteve që mbështesin integrimin social të grupeve të marginalizuara, të papunët, rininë rurale, forcën e punës të përfaqësuar nga gratë etj. Kjo masë ka gjithashtu për qëllim të inkurajojë aktivitete të përbashkëta kërkimore dhe edukative.

Të gjitha aktivitetet të lidhura me prioritetin 1 do të zbatohen me anë të granteve. “Kriteret e detajuara të përzgjedhjes dhe të dhënies së granteve do të përcaktohen në ftesën për projekt propozime-paketën e aplikimit (udhëzime për aplikuesit).

Plani kohor tregues dhe shuma treguese e ftesës për projektpropozime për prioritetin 1: Forcimi i zhvillimit ndërkufitar ekonomik, mjedisor dhe social.

Për buxhetin e vitit 2007 propozohet që të shpallen dy ftesa për projektpropozime dhe secila prej tyre të përmbajë tri masa. Ftesa e parë është konsideruar si një “Ftesë pilot”. Ajo do të fokusohet në grante të vogla dhe do të familjarizojë përfituesit finalë me procedurat e programit ndërkufitar dhe me akset e programit. Ftesa e dytë do të ketë një buxhet më të madh dhe do të përfshijë “grante të mëdha” (maksimumi 200 000 euro).

Ftesë për projektpropozime (prioriteti 1)	Data e shpalljes	Nënshkrimi i kontratave	Mbyllja e projektit	Shuma treguese IPA	Shuma treguese kombëtare	Shuma treguese TOTAL
ThPP 1: (tri masa; grante të vogla €20,000-50,000)	Gusht 2008	Janar 2009	Janar 2010	1,020,000	180,000	1,200,000
ThPP 2: (tri masa; grante të vogla €20,000-50,000 dhe grante të mëdha €50,000-200,000)	Dhjetor 2008	Maj 2009	Maj 2010	1,950,000	350,000	2,300,000
TOTAL				2,970,000	530,000	3,500,000

Prioriteti 2: Asistenca teknike

Fondet për asistencë teknike (AT) (10 % të kontributit të Komunitetit) do të përdoren për të mbështetur aktivitete të strukturës operacionale dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit. Fondet AT mund të përdoren për të mbuluar kostot për menaxhimin dhe implementimin e programit në secilin vend pjesëmarrës. Këto mund të përfshijnë, ndër të tjera, kostot e mëposhtme:

- Mbështetje për strukturat operacionale dhe për Komitetin e Përbashkët të Monitorimit;

- Ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antenës së tij, duke përfshirë kostot për stafin me përjashtim të pagave për nëpunësit nga sektori publik;
- Shpenzimet për pjesëmarrjen në takime të ndryshme që lidhen në zbatimin e programit;
- Kosto administrative dhe operacionale, duke përfshirë kostot për përgatitjen, monitorimin dhe vlerësimin e programeve, zgjedhjen e projekteve, organizimin e takimeve që lidhen me programin, kostot për përkthimin, informimin dhe publicitetin.

Referuar nenit 90(2) të rregullores (EC) nr.718/2007 (rregullorja e zbatimit IPA), prioriteti i asistencës teknike, ashtu si dhe çdo prioritet tjetër i programeve ndërkufitare, kërkon 15 % bashkëfinancim nga fondet kombëtare.

Duke pasur parasysh autoritetet kombëtare që janë dy strukturat operacionale kombëtare për bashkëpunimin ndërkufitar të cilat kanë në dorë *de facto* një situatë monopoliste (sipas nenit 168, paragrafi 1, nënparagrafi “c” e rregullores së zbatimit të rregullores financiare) për implementimin e programit ndërkufitar, ndërmjet Komisionit (Delegacioneve të Komisionit Europian) dhe autoriteteve kombëtare respektive do të arrihen marrëveshje direkte granti individuale pa Ftesë për projekt propozime për shumën e siguruar nga prioriteti AT.

Është i mundur subkontraktimi i aktiviteteve mbuluar nga marrëveshja direkte e grantit (p.sh. vlerësimi i AT, publiciteti etj.).

Marrëveshjet direkte të grantit mund të firmosen sapo marrëveshjet financiare janë nënshkruar (tremujori i parë 2008).

2.4 Vështrim mbi eksperiencën e tanishme dhe të kaluar ndërkufitare, duke përfshirë mësimet e nxjerra dhe koordinimin e donatorëve

Deri tani iniciativat ndërkufitare në zonën përfituese kanë prekur kryesisht çështjet mjedisore dhe janë përqendruar në zonën jugore. Megjithatë rajoni tashmë ka një rol udhëheqës në ngritjen e një menaxhimi të përbashkët transkufitar të burimeve natyrore, bashkëpunimi ndërkufitar është ende në një nivel të ulët.

Dinamika e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë ka nisur në 1997-1999 nëpërmjet programit shumë vendesh CREDO në kuadër të PHARE, i cili kishte për qëllim promovimin e marrëdhënies së mirë të fqinjësisë, stabilitetit social dhe zhvillimin ekonomik në zonën kufitare. Programi siguroi fonde për implementimin e projekteve ndërkufitare në fushat e mjedisit, bashkëpunimit të OJQ-ve dhe administratës lokale.

Edhe pse eurorajoni Prepsë-Ohër nuk është ngritur ende në mënyrë zyrtare në të gjitha vendet pjesëmarrëse, ai përbën një hap madhor drejt zhvillimit të integruar rajonal në zonën jugore të rajonit ndërkufitar. Duke u mbështetur nga Këshilli Europian, Instituti East-West dhe disa partnerë të tjerë, ngritja e Eurorajonit është padyshim inkurajuese për marrëdhëniet e partneritetit ndërmjet dy vendeve. Në kuadër të projektit Eurorajon, Instituti East-West ka shpallur tashmë dy ftesa për projektpropozime për projekte të vogla të bashkëpunimit ndërkufitar (në 2004 dhe 2006), duke marrë pjesë kështu në ngritjen e kapaciteteve të përfituesve.

Projekti për mbrojtjen e liqenit të Prespës është konsideruar shpesh si një model i integrimit të menaxhimit të burimeve ujore transkufitare. Në vitin 2004 qeveritë e të dy vendeve nënshkruan një marrëveshje për “mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe ujëndarësve të tij”. Ekzistenca e strukturave të përbashkëta, si dhe e një marrëveshje bilaterale sigurojnë një kuadër të mirë për iniciativë të mëtejshme ndërkufitare.

Mbështetur nga UNDP-ja dhe ende në një fazë fillestare, projekti transkufitar i Parkut të Prespës përfshin ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Shqipërinë dhe Greqinë. Kjo është një iniciativë tjetër ndërkufitare pionere në zonën e menaxhimit të burimeve natyrore.

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) mbështet iniciativë ndërkufitare ndërmjet Debarit në ish- -Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Peshkopisë në Shqipëri. Projekti trajnon vendimmarrësit lokalë dhe ekspertët përkatës për të identifikuar dhe përgatitur projekte investimesh në fushën e ambientit dhe për të paraqitur aplikime financiare profesionale. Probleme prioritare lidhur me sigurimin e ujit dhe mbledhjen dhe derdhjen e ujërave të zeza.

Organizata Ndërkufitare për Bashkëpunim e Zhvillim (ICCO-Holandë) mbështet bashkëpunimin ndërkufitar rajonal dhe rrjetin e shoqërisë civile në pjesën veriore të rajonit ndërkufitar. Ky program ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar duke ngritur

bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile dhe duke rritur kapacitetet organizative të organizatave përkatëse të shoqërisë civile.

Një iniciativë e OSBE-së përpiqet të lehtësojë partneritetet dhe të identifikojë projektet ndërkufitare në zonën veriore të rajonit ndërkufitar.

Mësimet e nxjerra

Pjesa më e madhe e iniciativave të filluara kohët e fundit, duke e bërë të parakohshëm përcaktimin e tyre “mësimet e nxjerra”. Megjithatë, për t’u theksuar janë çështjet e mëposhtme:

- Pjesa më e madhe e projekteve të implementuar janë fokusuar në çështje të mbrojtjes së ambientit. Këto projekte reflektojnë prioritetet e përcaktuara nga institucionet kombëtare dhe rajonale, duke kontribuar kështu për një përqendrim më të mirë në prioritetet e zhvillimit lokal dhe kombëtar. Megjithatë, është e rëndësishme të bashkëpunohet ngushtë me shoqërinë civile dhe sektorin privat në zhvillimin e programit. Duke lënë mënjane disa paragjykime në lidhje me politikën për “qeverisjen formale” në projektet aktuale, ato sigurojnë një kuadër të mirë për zhvillimin e shoqërisë civile dhe partneriteteve të OJQ-ve përgjatë kufirit.

- Ftesat e pakta për projekt propozime për projekte ndërkufitare të shpallura treguan një kapacitet të ulët në përgatitjen e projekteve të pothuajse të gjithë përfituesve të fundit. Kjo mund të pengojë zbatimin e programit, sidomos në pjesën veriore ku nuk është zbatuar pothuajse asnjë iniciativë (me përjashtim të aksit Debar-Peshkopi). Trajnime specifike për aplikantët potencialë do të shoqërojnë gjithë programin.

- Një numër i vogël bashkish, kryesisht në zonën e jugut, kanë pasur një rol udhëheqës në iniciativat ndërkufitare të kaluara dhe të tanishme. Këto bashki duhet të kenë një rol kryesor gjatë implementimit të programit (transferimi i njohurive etj.).

- Ngritja e partneriteteve operacionale dhe të qëndrueshme do të jetë një sfidë për pjesën më të madhe të përfituesve. Një mbështetje e veçantë do të kërkohej me qëllim që të lehtësohet komunikimi dhe ngritja e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare.

Koordinimi i donatorëve

Gjatë mbledhjeve të kaluara të komitetit IPA, vendet anëtare të BE-së shprehin dëshirën që ambasadat e tyre, si dhe degët lokale të institucioneve ndërkombëtare financiare dhe shoqëria civile duhet të konsultohen mbi dokumentet e programimit IPA. Këto konsultime janë kryer tashmë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë gjatë procesit të hartimit të MIPD 2007-2009.

Pas dërgimit të draftit të programit ndërkufitar në Komisionin Europian, delegacionet e qarkulluan atë në ambasadat e vendeve anëtare dhe zyrat lokale të institucioneve ndërkombëtare financiare në kryeqytete të vendeve. Komentet e ardhura u morën parasysh në finalizimin e programit ndërkufitar.

2.5 Çështje horizontale

- Shanse të barabarta dhe jodiskriminim;

I kushtëzuar nga detyrimet ligjore në të dy vendet, programi do të sigurojë akses të njëjtë për aktivitetet e programit për të gjitha grupet e ndryshme të shoqërisë civile. Në veçanti, masa 3 do të forcojë kohezionin social dhe shkëmbimet kulturore ndërmjet projekteve “njerëzit për njerëzit” dhe institucionet për institucionet” ndërmjet mbështetjes për integrim social për grupet e marginalizuara, të papunët, rininë rurale, forcën e punës të përfaqësuar nga gratë etj.

- Mbështetje për minoritetet dhe grupet në nevojë;

Masa 3 e prioritetit të parë ka për qëllim zhvillimin dhe implementimin e programit për integrimin social të grupeve në nevojë, si të papunët, rininë rurale dhe forcën e punës të përfaqësuar nga gratë. Pjesa më e madhe e projekteve për t’u implementuar në kuadër të kësaj mase synojnë vlerësimin e karakteristikave multietnike të rajonit, duke i konsideruar ato si një pasuri për zhvillimin ekonomik dhe social. Për këtë arsye pjesëmarrja e minoriteteve dhe e grupeve në nevojë në aktivitetet ndërkufitare do të inkurajohet fuqimisht.

- Mbrojtja e ambientit;

Masa 2 e prioritetit të parë i dedikohet plotësisht mbrojtjes së ambientit. Qëllimi i aktivitetëve të propozuara do të jetë rritja e ndërgjegjësimit mbi çështjet e ambientit dhe inkurajimi i sektorëve private dhe bashkive të vogla për të marrë pjesë në mënyrë më aktive në dinamikën e filluar tashmë në një nivel institucional.

- Mirëqeverisje, me një vëmendje të veçantë në luftën kundër korrupsionit.

Veçanërisht në kuadër të masës së parë, por gjithashtu dhe në masat e tjera, do jepet mbështetje zhvillimit të praktikave më të mira dhe planeve strategjike, transferimit të njohurive, si dhe lehtësimit të bashkëpunimit ndërkufitar. Gjithashtu, masa 2 do të stimulojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të ndryshme kombëtare dhe bashkiake për të hartuar politika mjedisore dhe programe pilot, ndërkohë që përfshirja e shoqërisë civile në këto aktivitete do të thellohet më tej.

2.6 Kushte

Grupi operacional është ngritur për të përgatitur programin ndërkufitar. Gjithsesi, zbatimi i programit mund të kërkojë një përbërje tjetër organizative. Përpara vitit 2007 të dy vendet kanë ngritur strukturën operationale në secilin vend.

2.7 Etapat

	N ¹ (2008)	N+1 (2009) (kumulative)	N+2 (2010) (kumulative)
Numri i marrëveshjeve direkte të grantit në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë	1		
Numri i marrëveshjeve direkte të grantit në Shqipëri	1		
Numri i thirrjeve të përbashkëta për projektpropozime të lancuara	2		
Niveli i kontraktimit (%) në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë	10 % ²	100 %	
Niveli i kontraktimit (%) në Shqipëri	10 % ²	100 %	

2.8 Plani për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni

Një plan me etapat treguese dhe limitet kohore për të realizuar decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni do të hartohet menjëherë pasi Komisioni t'i ketë akorduar kompetencat menaxhuese autoriteteve kombëtare.

Për sa i përket planit tregues për decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* (sistemi i zbatimit të decentralizuar- DIS), situata është si në vijim:

Në rastin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ngritja e një sistemi menaxhimi dhe kontrolli është vendosur nga qeveria në dhjetor 2006. Janë ngritur fondi kombëtar (NF) dhe njëسيا qendrore për financim dhe kontraktim (CFCU) dhe janë emëruar oficeri i autorizuar i programit (PAO), oficeri kompetent i akreditimit (CAO) dhe oficeri i lartë i programit (SPOs).

Në hapet e para në 2005 u iniciua një vlerësim nevojash i lidhur me decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së dhe rezultatet i janë prezantuar Komisionit. Një përditësim i vlerësimit të nevojave për t'u përshtatur me rregulloren e re të zbatimit IPA është përgatitur në

¹ n është data për arritjen e Marrëveshjes Financiare

² në 2008 do të kontraktohet vetëm AT (€ 330.000)

gjysmën e dytë të vitit 2007 dhe në vijim të kësaj autoritetet kombëtare kanë dërguar një raport mbi vlerësimin e nevojave. Në vijim është bërë një analizë për plotësimin e nevojave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007, i ndjekur nga një vlerësim përputhshmërie. Pas akreditimit të sistemit në presim më pas oficerin kompetent të akreditimit (CAO) për të dërguar aplikimin në Komision për aprovimin e menaxhimit.

Në rastin e Shqipërisë, një mision nga njësia ELARG E.5 u zhvillua në prill 2007. Gjatë misionit autoritetet shqiptare morën draftin për “Procesin e DIS”. Autoritetet janë duke punuar për planifikimin. Projekti 2 i financuar nga komponenti I i IPA-s për Shqipërinë për vitin 2007 do të sigurojë një vlerësim të thelluar të strukturave ekzistuese administrative në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë kryesore të Linjës të përfshira në asistencën e BE-së dhe gatishmërinë e tyre për të marrë përgjegjësitë e DIS.

3. Buxheti i vitit 2007

3.1 Tabela financiare integruese për vitin 2007 për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

	Asistencë BE – IPA		Kontributi kombëtar		Total (IPA plus kontributi kombëtar)	
	EUR	%	EUR	(%)	EUR	(%)
Prioriteti 1	1,980,000	85	350,000	15	2,330,000	100
Prioriteti 2	220,000	85	40,000	15	260,000	100
TOTAL	2,200,000	85	390,000	15	2,590,000	100%

3.2 Tabela financiare treguese për vitin 2007 për Shqipërinë

	Asistencë BE – IPA		Kontributi kombëtar		Total (IPA plus kontributi kombëtar)	
	EUR	%	EUR	(%)	EUR	(%)
Prioriteti 1	990,000	85	180,000	15	1,170,000	100
Prioriteti 2	110,000	85	20,000	15	130,000	100
TOTAL	1,100,000	85	200,000	15	1,300,000	100%

3.3 Principi i bashkëfinancimit i aplikueshëm për projektet të financuara nga ky program

Kontributi i Komunitetit është përlogaritur në lidhje me shpenzimet e lejueshme, të cilat për programin ndërkufitar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë është bazuar në shpenzimet totale, siç është rënë dakord nga vendet pjesëmarrëse dhe përcaktuar në dokumentin e programit.

Aplikohen rregullat sipas nenit 90 të rregullores (EC) 718 datë 12/06/2007 (rregullorja e zbatimit IPA).

4. Marrëveshjet për implementimin

Të dy vendet do të menaxhojnë programin sipas modelit të menaxhimit³ të centralizuar. Rregullat për implementimin e programit janë bazuar në principin e të dy vendeve përfituese që janë partnere të barabarta dhe kanë një rol të njëjtë në strukturat menaxhuese të programit ndërkufitar. Menaxhimi i përbashkët i programit do të sigurojë një zotërim lokal, përfshirje të gjerë, planifikim më të mirë dhe do të krijojë një bazë për aktivitete të sinqerta ndërkufitare.

4.1 Metoda e implementimit

Ky program do të implementohet në një bazë të centralizuar nga Komisioni European në

³ Për të dy vendet qëllimi është i decentralizuar. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është në proces të përgatitjes së akreditimit të dy strukturave menaxhuese. Ky proces pritet të përfundojë në vitin 2008 dhe më pas vendi do të aplikojë një model të menaxhimit të decentralizuar. Një proces i njeshëm ka nisur gjithashtu edhe në Shqipëri.

përputhje me nenit 53a të rregullores financiare⁴ dhe që i përgjigjet rregullave të rregullores së zbatimit IPA⁵.

Në rast të menaxhimit të centralizuar, roli i Komisionit në selektimin e projekteve në kuadër të një programi ndërkufitar ndërmjet vendeve përfituese është përcaktuar në nenin 40 të rregullores së zbatimit IPA.

4.2 Rregulla të përgjithshme për prokurimin dhe procedurat e dhënies së grantit

Prokurimi do të ndjekë rregullat e përcaktuara në pjesën II, titulli IV në rregullores financiare, si dhe ato në pjesën II, titulli III, kapitulli 3 të rregullores së zbatimit⁶, gjithashtu dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, paisjeve, dhe punëve që financohen nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllimet e bashkëpunimit me vendet e treta aprovuar nga Komisioni në 24 maj 2007 (C(2007)2034).

Procedurat e dhënies së grantit do të ndjekin rregullat e pjesës së parë, titulli VI në rregulloren financiare dhe pjesën e parë, titulli VI në rregulloren e zbatimit.

Aty ku është e përshtatshme, autoritetet kontraktuese do të përdorin dokumentet dhe modelet standarde duke lehtësuar kështu aplikimin e rregullave të sipërpërmenduar të përcaktuara për këtë qëllim në "Udhëzuesin praktik të procedurave të kontraktimit për veprime të jashtme të KE-së" (Udhëzuesi praktik), i cili publikohet në faqen e internetit të EuropeAid⁷ në ditën e fillimit të procedurave të prokurimit dhe dhënies së grantit.

4.3 Vlerësim i ndikimit në mjedis dhe mbrojtja e natyrës (në raste të nevojshme)

Të gjitha investimet do të realizohen në përputhje me legjislacionin përkatës të Komunitetit mbi mjedisin.

Procedurat për vlerësimin e rolit të mjedisit siç janë përcaktuar në direktivën EIA⁸ do të aplikohen tërësisht për të gjitha projektet e investimeve në kuadër të IPA-s. Nëse Direktiva EIA nuk është transpozuar ende procedurat do të jenë të ngjashme me ato të përcaktuara në direktivën e sipërpërmendur.

Nëse projekti mund të ndikojë vende të rëndësishme të mbrojtjes së natyrës duhet të bëhet një vlerësim i mbrojtjes së natyrës dhe të dokumentohet që është e njëjtë me atë që parashikohet në nenin 6 të direktivës për habitatet⁹.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1 Monitorimi

Implementimi i programit ndërkufitar do të monitorohet nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, të ngritur nga vendet përfituese, dhe që përfshin dhe përfaqësues të Komisionit, sipas nenit 142 të rregullores së zbatimit IPA.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Shqipëri, Komisioni mund të ndërmarrë çdo aksion që lind i nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2 Vlerësimi

Programet do të jenë subjekt për vlerësim në përputhje me nenin 141 të rregullores së zbatimit IPA, me qëllimin për të përmirësuar cilësinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e asistencës nga fondet e Komunitetit dhe strategjinë e implementimit të programeve ndërkufitare.

6. Auditit, kontrolli financiar, masat kundër mashtrimit;

Të gjitha veprimet dhe aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në implementim, si dhe të

⁴ Rregullorja 1605/2002 (OJ L 248, 16.9.2002, fq.1.) e amenduar nga rregullorja (EC, Euratom) nr.1995/2006 (OJ L 390, 30.12.2006, fq.1)..

⁵ Rregullorja 2342/2002 (OJ L 357, 31.12.2002, p. 1) e amenduar së fundmi nga rregullorja (EC, Euratom) nr. 478/2007 (OJ L 111, 28.4.2007, fq. 1).

⁶ Shiko më lart shënimet 2 dhe 3

⁷ Adresa aktuale:

⁸ Direktiva e Këshillit 85/337/EEC datë 27 June 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (OJ L 175, 5.7.1985, fq. 40). Direktiva e amenduar së fundmi nga rregullorja 2003/35/EC, OJ L 156, 25.6.2003, fq. 17.

⁹ Direktiva e Këshillit 92/43/EEC datë 21 maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktiva e amenduar së fundmi nga rregullorja (EC) No 1882/2003 (OJ L284, 31.10.2003, fq. 1)

gjitha kontratat dhe marrëveshjet që zbatojnë këtë program, janë subjekt: a) të mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar nga Komisioni (duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit), e cila mund të kryejë kontrolle me një liri të plotë veprimi, ose vetë ose ndërmjet një auditori të jashtëm, dhe b) auditimeve nga Gjykata Europiane e Auditorëve. Kjo përfshin masa, si verifikime *ex-ante* të procesit të tenderimit dhe kontraktimit të kryera nga delegacionet në vendet përfituese.

Me qëllim për të siguruar një mbrojtje efikase të interesave financiare të Komunitetit, Komisioni (duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit) mund të ushtrojë kontrolle në vend dhe inspektime në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96¹⁰.

Kontrollet dhe auditimet e përshkruara më lart janë të aplikueshme për të gjithë kontraktorët, subkontraktorët dhe përfituesit e grantit, të cilët kanë përfituar fonde të Komunitetit.

7. Ndryshime të kufizuara

Ndryshime të kufizuara në implementimin e këtij programi që prekin elemente themelore të listuara në nenin 90 të rregullave të implementimit të rregullores financiare, të cilat janë të një natyre treguese¹¹, mund të ndërmerren nga nëpunësi i autorizuar nga Komisioni me anë të delegimit (AOD), në përputhje me delegimin e kompetencave të akorduara atij nga AOD, në përputhje me principet e një menaxhimi financiar të harmonizuar pa qenë e nevojshme një vendim ndryshimi financiar.

SHTOJCA A2

PROGRAMI NDERKUFITAR 2007-2013 IPA CBC

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISE – SHQIPERI

FJALORI I AKRONIMEVE

CBC	Bashkepunimi Nder-kufitar
CBIB	Ndertimi I institucioneve nder-kufitare
CEFTA	Marreveshja e Lire e Tregtise se Europes Qendrore
EU	Bashkimi European
GDP	Produkti I Brendshem Bruto
IPA	Instrumenti i Asistences se Para Aderimit
IUCN	Organizata Boterore per Mbrojtjen e Natyres
JMC	Komiteti i Perbashket i Monitorimit
JTS	Sekretariati i Perbashket Teknik
MDG	Objektiva e Zhvillimit te Mijevjecarit
MPDP	Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumevjecar
NDP	Plani Kombetar i Zhvillimit
NGO	Organizate Jo Qeveritare
NSSD	Strategjia Kombetare per Zhvillimin Ekonomik dhe Social
NUTS	Nomenklatura e Njesive per Statistika Territoriale
OS	Struktura Operacionale
OSCE	Organizata per Siguri dhe Bashkepunim ne Europe
PRAG	Udhezues Praktik per Procedurat e Kontraktimit financuar nga buxheti i pergjithshem i Bashkimit European ne kontekstin e projekteve te jashtme
SAA	Masreveshja e Stabilizim Asociimit
SME	Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme
SWOT	Pikat e forta, Pikat e dobeta, Mundesite, Risku
TA	Asistenca Teknike
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve te Bashkuara
UNSCR	Rezoluta e Keshillit te Sigurise te Kombeve te Bashkuara
VET	Trajnimi dhe Edukimi Profesional

¹⁰ Regullorja e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96 datë 11 nëntor 1996, OJ L 292; 15.11.1996; fq. 2.

¹¹ Këto elemente themelore janë të një natyre indikative për grante, shuma indikative e ftesës për projekt propozime dhe për prokurime numri tregues dhe tipi i kontratave të parashikuara dhe koha treguese për fillimin e procedurave të prokurimit.

1. Hyrja dhe procesi i programimit

Programi ndërkufitar mes ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë do të zbatohet në periudhën 2007-2013. Ky dokument strategjik është bazuar në një proces planifikimi të përbashkët strategjik mes dy vendeve dhe është gjithashtu rezultat i një procesi të gjatë konsultimesh me autoritetet lokale dhe përfituesve potenciale. Objektivi i programit ndërkufitar është të promovojë marrëdhënjet e mira të fqinjësisë, të forcojë stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin, e cila është në interes të përbashkët mes dy vendeve dhe inkurajon zhvillimin e harmonizuar, balancuar dhe të qëndrueshëm të tyre.

Objektivi i të dy vendeve është të antaresohen në Bashkimin Europian. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE në Prill 2001 dhe ka marrë statusin e shtetit kandidat për në BE në Dhjetor 2005. Shqipëria ka nënshkruar MSA në Qershor 2006.

Programi do të prezantojë disa aktivitete të reja dhe inovative në kufi ku shpeshësia e qarkullimit të popullsisë dhe mallrave nuk është shumë e lartë. Si rrjedhojë të historisë së këtyre vendeve dhe natyrës malore të rajoneve kufitare, programi nuk po ndërtohet mbi një traditë të vjetër të iniciativave të përbashkëta dhe partnershit. Përveç arritjeve të dukshme të koheve të fundit, vecanërisht në sektorin e mjedisit dhe në pjesën jugore të zonave ndërkufitare, partneriteti me autoritetet lokale dhe shoqërisë civile, si dhe komunitetin e biznesit, janë ende në fazën fillestare. Motivimi i autoritetëve lokale dhe i popullsisë për të përdorur mundësitë e ofruara nga IPA Komponenti i II-të dhe paisja e tyre me kapacitetet e nevojshme për ta bërë këtë do të përbejë një sfidë më të madhe për të dy vendet.

Procesi i programimit

Procesi i programimit është shtrirë në mes Dhjetor 2006 deri në Maj 2007. Projekti CBIB, një projekt rajonal i financuar nga Bashkimi Europian asistoi autoritetet kombëtare dhe strukturat e përbashkëta në këtë proces.

Data dhe vendi	
18 Dhjetor 2006 Tiranë, Shqipëri	Takimi fillestar me koordinatoret e Bashkëpunimit Nderkufitar, identifikimi i strukturave përgjegjëse për përgatitjen e marrëveshjes së programit ndërkufitar në kohë
Dhjetor 2006-janar 2007	Ngritja e skuadrave operuese dhe i Komitetit të Përbashkët të Programimit
6 Shkurt 2007 Beograd, Serbia	Takimi i komitetit të përbashkët të programimit. Marrëveshje për planin e veprimit dhe prezantimi i zonave përfituese.
Shkurt-mars 2007	Konsultimi me aktorët kryesorë gjatë procesit të analizës SWOT.
Mars-maj 2007	Takime të ndryshme me skuadrave operuese, diskutime dhe komente mbi situatën dhe analizat SWO, si dhe prioritetet dhe masat. Pjesëmarrja e ministrave të linjës në prioritetet e përcaktuara.
12 prill 2007 Ohrid, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë	Takim i Komitetit të Përbashkët të Programimit. Aprovimi formal i rajoneve ndërkufitare. Paraqitja e analizave të situatës dhe diskutim mbi prioritetet dhe masat.
11 maj 2007 Kicevo, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Workshop me përfituesit finale dhe aktorët lokale. Prezantimi i projekt programit ndërkufitar dhe diskutimi mbi prioritetet dhe masat.

¹² Organizate Kombëtare

23 maj 2007 Korça, Shqiperi	Takim i Komitetit të Përbashkët të Programimit për aprovimin e projekt programit ndërkufitar
Korrik-gusht 2007	Shtetet antare të BE (ambasadat në Tiranë dhe Shkup) and Institucionet financiare janë konsultuar mbi draft programin për të identifikuar përputhshmerinë mes projekteve të donatoreve të ndryshëm

2. Harta dhe përshkrimi i zonave përfituese



Territori i zonave përfituese për programin ndërkufitar mes ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë mbulon rreth 19 969 km², me një popullsi totale prej 1 524 674 banorësh. Gjatesia e vijës kufitare është 191 km (tokë 151 km, lumë 12 km dhe liqen 28 km) me katër posta kufitare që operojnë në mënyrë permanente dhe një postë që operon me rastë.

	Zona(km katror)	% e totalit të territorit të vendit
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ¹³	25,713	100 %
Zona ndërkufitare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë	10,473	40.7 %
Pelagonia	4,717	18.3 %
Southwest	3,340	13.0 %
Polog	2,416	9.4 %
Shqipëria	28,748	100 %
Zona ndërkufitare me Shqipërinë	9,496	33.0 %
Korçë	3,711	12.9 %

¹³ Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave



Diber	2,586	9.0 %
Elbasan	3,199	11.1 %
Total zona nderkufitare	19,969	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise eshte 52.5% dhe territori i Shqiperise eshte 47.5% e zones nderkufitare.

Zona nderkufitare qe perfiton nga ky program eshte përcaktuar ne përputhje me nenin 88 te Rregullores se Zbatimit te IPA ku eshte përcaktuar se niveli NUTS 3 ose zonat ekuivalente pergjate kufijve toksores ne kufi mes dy vendeve jane përfituese per programet nderkufitare.

Ne anen e Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise, zonat përfituese jane tre rajone ekuivalente me nivelin statistikor NUTS 3. Vendi eshte i ndare ne 8 rajone statistikore te vendosura ne vitin 2001 me nje vendim te Qeverise (Nomenklatura Kombetare e Njesive Territoriale Statistikore).

Ne Shqiperi Zonat përfituese konsistojne ne tre rajone administrative (vendi eshte i ndare ne 12 rajone) qe i korrespondojne nivelit NUTS 3.

Territori i zonave përfituese ne te dy vendet eshte pothuaj i njejte.



Zona Kufitare ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise perfshin Pelagonia, Southwest and Polog te nivelit NUTS 3 ekuivalent me zonen statistikore qe mbulon 10 473 km katror, me nje total popullsie prej 766 820 banoresh. Ajo konsiston ne 31 bashki qe perfshin 813 nenndarje (12 qytete dhe 801 fshatra).

- Rajoni Pelagonia perfshin 9 bashki - Bitola, Mogila, Novaci, Demir Hisar, Krusevo, Prilep, Dolneni, Krivogastani dhe Resen;

- Rajoni Jugperendimor perfshin 13 bashki - Debar, Centar Zupa, Kicevo, Vranestica, Drugovo, Zajas, Oslomej, Makedonski Brod, Plasnica, Ohrid, Debarca, Struga dhe Vevcani;

- Rajoni Polog perfshin 9 bashki - Gostivar, Vrapciste, Mavrovo and Rostusa, Tetovo, Bogovinje, Brvenica, Zelino, Jegunovce dhe Tearce.

Tre rajonet kufitare ne Shqiperi qe mbulojne 9 496 km katror, me nje total popullsie prej 757 854 banoresh. Ato jane te ndara ne 12 distrikte dhe 122 njesi me te vogla territoriale (17 bashki dhe 105 komuna, qe perfshijne 18 qytete dhe 1021 fshatra)

- Qarku i Dibres qe perfshin bashkine e Dibres, Burrelit dhe Bulqizez;

- Elbasan Region qe perfshin bashkine e Elbasanit, Librazhdit, Gramshit, Cerrikut and Peqinit,

- Rajoni i Korces perfshin bashkine e Korces, Pogradecit, Devollit dhe Kolonja

3. Situata aktuale ne zonat perfituese



3.1 Demografi

Popullsia totale ne rajonin ndërkufitar eshte 1,524,674 banore dhe eshte i shperndare pothuaj njelloj per te dy anet e kufirit. Sidoqofte, trendi demografik ne te dy vendet eshte i ndryshem. Diferenca te ndjeshme jane vene re midis rajoneve dhe bashkive ne secilin vend, vecanerisht mes pjeses jugore dhe veriore.

	Popullsia (2004)	Dendesia e popullsise (persona/km2)	Norma e rritjes se popullesise	Norma mesatare e moshes(%)
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise ¹⁴	2,032,544	79.05	0.28	44.95
Zona nderkufitare ne ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise	766,820	73.22	0.67	47.80
Pelagonia	237,156	50.28	-0.21	47.45
Southwest	222,414	66.59	0.23	47.46
Polog	307,250	127.17	0.52	48.33
Shqiperia	3,142,065	109.30	?	57.48
Zona nderkufitare me Shqiperine	757,854	79.80	-0.74	58.86
Korce	345,793	108.10	-0.22	58.73
Diber	258,784	69.70	0.18	54.32
Elbasan	153,277	59.30	-3.22	67.50
Total zona nderkufitare	1,524,674			

Ngjashmerite

- Numri i banoreve eshte pothuaj i njejte ne te dy anet e rajonit kufitar
- Dendesia e popullsesise eshte e ulet, nen mesataren kombetare ne te dy vendet, pervec Rajonit te Pologut, e cila ka dendesine me te madhe ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe Elbasani i cili eshte afer normes mesatare te dendesise kombetare



Differences

- Shqiperia eshte me shume e afektuar nga emigrimi dhe migrimi ne qytetet me te medha se sa Ish Republika Jugosllave e Maqedonise, cka con ne nje renie te dendesise dhe rritjes se popullsesise. Ne dekadën e fundit ritmi i rritjes se popullsesise ne te tere zonen kufitare shqiptare eshte negative, ndersa ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise ky ritem eshte negativ vetem ne Pelagonia (si pasoje e migrimit por dhe e moshes se popullsesise). Rajoni Polog ka normen me te larte te rritjes se

¹⁴ Burimi: Zyra Shtetërore e Statistikave

popullesise ne vend. Reduktimi i forces se punes eshte pasoje e fenomenit te migrimit ne Shqiperi, gje qe perfshin me teper meshkujt ne moshe pune. Gjithashtu ka nje impakt ne strukturen e popullesise, qe sic tregojne edhe te dhenat aktuale grate kane kaluar ne numer burrat, sidomos ne Rajonin e Dibres.

- Norma e varesise se moshes ne secilen ane te kufirit eshte me e larte se ajo respektive kombetare, por per arsye te ndryshme. Ne Shqiperi eshte si shkak i normes se larte te te rinjeve (0-14 vjec). Ne te kundert me kete, ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, si shkak te normes se larte te personave ne moshe (me shume se 65 vjecare), me perjashtim te Pologut qe ka nje shperndarje moshe pothuaj te njejte me Shqiperine.

- Megjithese fenomeni i migrimit ne Shqiperi po ndryshon perqindjen e popullesise urbane dhe rurale, niveli i urbanizimit eshte ende me i larte ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise (48% e popullesise se zones nderkufitare) se sa ne Shqiperi (33% e popullesise se zones nderkufitare). Sidoqofte Rajoni i Pologut perseri ka te njejte norme Popullesie urbane-rurale si ne Shqiperi.

Çeshtjet kryesore nderkufitare lidhur me demografine

- Mundesi per te ngritur strtegji te njejta per te shmangur ritmet negative te rritjes dhe boshatisjes se disa zonave rurale si pasoje e emigrimit ose- dhe moshes se banoreve.

- Mundesi per te trajtuar se bashku normen e larte te te rinjeve ne Shqiperi dhe ne pjesen veriore te ish republikes Jugosllave te Maqedonise

- Mundesi per te trajtuar bashkarisht rolin e grave dhe organizatave te grave, vecanerisht ne zonat rurale ku grate jane me shume se burra.

3.2 TE DHENAT GJEOGRAFIKE

E vendosur me pjesen jugore te Europes, rajoni nderkufitar ka nje profil te ndryshem gjeografik. Ai eshte i dominuar nga grupi i maleve Dinarike qe kane masive te natyres alpine (si Pelagonia dhe Gramazi ne jug dhe midis dy vendeve). Golem Korabi (2753 m) eshte maja me e larte ne rajon. Zona malore eshte e pasur me pyje (pyjet mbulojne 44% te territorit nderkufitar te ish Republikes Jugosllave te Maqedonise dhe 37% te zones shqiptare), me kafshe te egra dhe kullota. Eshte nje zone qe ka tradite ne rritjen e dheneve dhe eshte e konsideruar si nje nga kullotat me te medha ne Europe. Permban nje numer te madh vlerash natyrore si liqene akulli, guva akulli dhe kanione spektakolare, si kanioni i lumit te Radikas.

Nje tjeter pjese e konsiderueshme e rajonit nderkufitar jane lugina dhe fusha, te cilat variojne ne madhesi, dendesi popullesie, bimesi dhe lartesi (nga 130 ne 880 m). Me te medhte, si dhe njekohesisht me pjellorja, ajne fusha e Pelagonija mes Bitola dhe Prilep, fusha Ohrid-Struga, fush e Korces dhe fusha Polog mes Tetovo dhe Gostivar. Fushat e Pelagonise dhe Korces ne pjesen jugore jane me te njohurat nga pikëpamja bujqesore ne te dy vendet. Disa fusha te tjera bujqesore The Pelagonia and Korca plains in the southern part are known as the most favourable agriculture areas in both countries. Several other fertile abujqesore shtrihen ne luginat e lumenjve me te rendesishem (Mat, Shkumbini, Drin...) te cilat ofrojne edhe kushte me te favorshme per rritjen dhe kultivimin e perimeve e frutave.

Lumenjte natyrale ne jug jane te njohur botërisht dhe perbejne atraksionin me te madh te rajonit ndërkufitar. Liqeni i Ohrit eshte liqeni i dyte tektonik ne Ballkan. I klasifikuar si nje nga liqenet me te mëdhenj ne bote, ai shtrihet ne nje lartesi 693 m dhe mbulon nje hapësire prej 349 kilomentrash katrore (nga te cilat 66% i përkasin ish Republikes Jugosllave te Maqedonise dhe 34% Shqiperise). Kushtet natyrore kane bere te mundur jetesen e disa formash jete qe nga koha parahistorike, keshtu qe liqeni ofron edhe nje muzeum te fosileve te gjalla. Eshte vendarritja e 18 lloje , duke perfshire edhe troften e vetme dhe te famshme te këtij liqeni. Vezet e peshkut "plasica" (red-spotted trout) perdoren per prodhimin e "Perlave te Ohrid-it", te regjistruara ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise si Marke e Mbrojtur Origjine. Ne 1980, Liqeni i Ohrit u deklarua nga UNESCO Zone e Mbrojtur Kulturele dhe Natyrale, per shkak te historise se pasur me Faune dhe flore unike. Fakti qe Liqeni i Ohrit eshte nje liqen ndërkufitar paraqet nje sfide shtese per menaxhimin e tij te qendrueshem.

Liqeni i Prespes i vendosur ne ultesiren e Prespes e cila mbulon nje hapësire 274 km², nga te cilat 64.5% i përkasin ish Republikes Jugosllave te Maqedonise, 18% Shqiperise dhe 17.5% Greqise. Liqeni i Prespes dhe zonat e tij te mbrojtura rreth (ne te tre vendet) jane pjese e nje projekti te madh te quajtur Prespa Park.

Ka edhe liqene te tjere natyral dhe artificiale te vendosura ne zonen nderkufitare, e cila perben

nje potencial vlerash turistike dhe jane: shtae liqenet e Lures, Liqeni i zi i Dibres, kater liqene artificiale ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise (Mavrovo, Globotchica, Debar Lake and Strezhevo).

Rajoni ndërkufitar ka nje klime e cila derivon nga kalimtare kontinentale ne veri ne kalimtare mesdhetare ne jug dhe ne qender. Megjithate ne pjesen malore te ketyre zonave dimri eshte i ftohte dhe i lagesht ndersa vera eshte e nxehte dhe e thate. Temperatura ne zonat malora varion nga -16 ne 36 grade.

Zona kufitare eshte e pasur ne minerale si krom, qymyr, hekur-nikel, baker, gëlqere, rere kuarx dhe mermer.

Ceshtjet kryesore te lidhura me te dhenat gjeografike:

Zona nderkufitare ne te dy vendet ka disa te dhena gjeografike, potenciale te njëjta per zhvillimin e burimeve natyrore dhe dhe kushte te njëjta lidhur me mbrojtjen dhe permiresimin e ketyre burimeve.

- Te dy vendet ndajne vlere te njëjta te burimeve natyrore, vecanerisht Liqenet e Ohrit dhe te Prespes, si dhe lumin Drin.


- Komunikimi mes dy vendeve eshte me i lehte ne zonen jugore (Korridori VIII Pan European) se ne zonen veriore, e cila dominohet nga male te larte dhe ku përfituesit kane me shume veshtiresi ne vendosjen e bashkëpunimeve dhe përpunimin e projekteve te perbashketa.

3.3 Infrastruktura

3.3.1 Rruget

Korridori i VIII Pan European qe lidh rajonin Adriatik-Jon me Ballkanin lindor dhe vendet e detit te zi eshte rruga kryesore qe kalon ne rajonin ndërkufitar. Ajo lidh portin e Duresit, Tiranen dhe Shkupin me piken e kufirit ne pjesen jugore te rajonit (Qafe Thane-Struga). Pritet qe Korridori VIII te kthehet ne nje sistem multi-modal transporti qe perfshin porte detare, aeroporte, rruge dhe hekurudha. Nderkohe, seksioni Gostivar-Skopje ka tashme nje status rrugor. Ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, pjesa lindore e zones kufitare gjithashtu kalohet nga nje segment i Korridorit 10, qe lidh Ballkanin verior me ate jugor.

Te tre rajonet e Shqiperise kane 772 km rruge kombetare dhe 6 102 km rruge rurale ne total. Aksi jugor Elbasan-Korce-Qafe Thane eshte rikonstruktuar kohet e fundit dhe ka standarde evropiane, por aksi verior Mat-Bulqize-Peshkopi eshte ne kushte te renda, duke demtuar shkëmbimet tregtare me ish Republiken Jugosllave te Maqedonise. Pjesa me e madhe e rrugeve rurale eshte e shtruar me zhavorr. Te rejonet ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise kane nje total prej 3 292 km rruge lokale (nga te cilat vetem 1 998 km jane te shtruara me asfalt). Rrjeti i rrugeve kombetare eshte ne kushte te mira dhe arrin standardet evropiane.



3.3.2 Pikat e kalimit kufitar

Per shkak te gjeografise, si dhe te kushteve te infrastruktures rrugore, lidhja mes dy vendeve eshte me intence dhe e lehte ne pjesen jugore se ne pjesen veriore. Aktualisht jane kater posta kufitare: Ne Bllate qe lidh qytetin e Debar me Peshkopine, ne Kafasan (Qaf-Thane) qe lidh qytetin e Struges me Kapshticen, ne Sveti Naum prane Ohrit dhe ne Stenje prane Resen. Pika e peste e kalimit e cila punon me raste eshte ne rajonin Polog-Dibra. Nderkohe vetem Kafasan/Qafe Thane eshte i kompletuar teresisht per kalim te mallrave te renda. Eshte ne plan hapja e nje pike te re te kalimit te kufirit (Djepiste-Trebisht).

3.3.3 Hekurrudhat

Nuk ka lidhje hekurudhore mes dy vendeve. Ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dy linja hekurudhore lidhin Shkupin me rajonin ndërkufitar. Ne pjesen veriore, rreth 110 km linje hekurudhore lidhin Skopje, Tetovo, Gostivar dhe Kicevo. Ne pjesen Jugore, Bitola lidhet me Shkupin me nje zgjatje te linjes hekurudhore Skopje-Veles. Ne Shqiperi, ka vetem nje linje hekurudhore Pogradec – Durres qe lidh kete rajon me pjeset e tjera te rrjetit shqiptar, por kushtet jane shume te renda. Ne te dy vendet, transporti hekurudhor i mallrave dhe pasagjereve po rritet ne menyre konstante dhe eshte nje plan per shtrirjen dhe modernizimin e rrjetit hekurudhor dhe ndertimin e nje linje hekurudhore mes Bullgarise dhe Shqiperise mes Korridorit 8.

3.3.4 Aeroportet

Ohri eshte i vetmi aeroport per pasagjeret ne rajonin ndërkufitar. Numri i pasagjereve (mbërritjet dhe nisjet) ne aeroportin e Ohrit ne 2005 ishte 53,930 (9,4% e numrit total te pasagjereve ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise. Me shume se 50 % e trafikut ne aeroportin e Ohrit mbulohet me avione charter, qe dëshmon lidhjen turistike. Afersia mes aeroportit te Shkupit dhe Tiranës eshte gjithashtu nje vlere e madhe per rajonin ndërkufitar (aeroporti i Ohrit ofron shërbime me shume ne pjesen jugore).

3.3.5 Telekomunikimi

Te gjitha qytetet dhe pjesa me e madhe e fshatrave ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise jane te lidhura me rrjetin kombëtar dhe nderkombetar te komunikimit, por përqindja e te rregjistruarve eshte me e larte ne pjesen Jugore (36 ste rregjistruar per 100 banore ne Oher) se ne pjesen veriore (8 te rregjistruar per 100 banore ne Tetovo).

Ne Shqiperi, numri i pergjithshem i te rregjistruarve me linje toksore dhe telefoni celulare (familje dhe përdorues te tjere) eshte 16 025, duke perbere rreth 7% ne te gjithe Shqiperine. Funksionimi i dobet i sistemit toksor dhe mbulimi i tij i (vetem 23 % te shtepive) eshte zevendesuar nga përdormi i telefonise celulare te ofruar ne Shqiperi vetem nga dy operatore private, me nje kosto relativisht te larte krahasuar e te ardhurat e popullsesise lokale dhe/ose tarifat e aplikuar ne vendet e tjera.

Informacion te sakte mbi aksesin ne internet ne rajonin ndërkufitar nuk ka por duhet te jete me i ulet se sa mesatarja kombetare (ne 2004, 78 persona per 1 000 ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise dhe 24 persona per 1000 ne Shqiperi) dhe e pamjaftueshme sipas intervistave te bera gjate analizes SWOT. Kjo si shkak i mosfunksionimit te mire te linjes toksore dhe mbulimit te dobet te saj ne Shqiperi, si dhe i cmimeve te larta dhe arsimit te ulet ne te dy vendet.

3.3.6 Furnizimi me uje, ujerat e zeza, depozitimi i mbetjeve

Ne ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise, 96,5 % te shtëpive ne zonen nderkufitare jane te pajisura me rrjet uji dhe sistem ujerash te zeza (sistem ne nivel bashkie ose individual) Ne zonat urbane kapacitetet e furnizimit me uje dhe cilësia e higjenes jane te kënaqshme, ndersa cilësia e ujit eshte problem ne mjaft zona rurale. Vetem ne pak qytete (Ohrid, Struga, Resen and Makedonski Brod) kane sistem kanalizimesh me impiante te trajtimit te ujerave te zeza. Mungesa e trajtimit te ujerave te zeza si dhe nje menaxhim adekuat i mbetjeve konsiderohet si rreziku me madh ndaj mjedisit dhe shëndetit te popullsesise ne rajonin ndërkufitar

Ne te tre rajonet ne Shqiperi, 80 % e shtëpive kane akses hyrje ne rrjetin e ujit te pijshem, i vendosur jashte dhe brenda territorit te shtepise. Situata eshte me problematike ne rajonin e Dibres, i cili ka nje pjese te madhe te shtëpive qe e marrin ujin nga burimet dhe puset. Ne zonat urbane, furnizimi ditor me uje eshte i paket, sidomos ne vere. Kapacitetet aktuale te rrjetit te furnizimit uJOR nuk përmbushin nevojat e popullsesise e cila po shtohet ne numer. Zonat urbane ne zonen nderkufitare kane nje sistem ujerash edhe per ujerat e zeza edhe per shiun, dhe pjesa me e madhe e popullsesise ne zonat rurale perdorin gropat septike. Kushtet teknike ne sistemin aktual te ujerave te zeza ne qytetet me te medha jane te keqija, si pasoje e investimeve te pakta, mirëmbajtjes se rregullt dhe ndertimeve te reja. Nuk ekziston asnjë impiant i përpunimit te ujerave te zeza, keshtu qe sipërfaqja e ujit prane qendrave te medha eshte e ndotur nga ujerat e papërpunuara.

3.3.7 Elektriciteti

Te gjitha shtepite ne te dy anet e zones nderkufitare kane akses ne sistemin kombëtar te energjise. Persa i perket elektricitetit, zona nderkufitare ne Shqiperi eshte ne shtate me te veshtire, apsi konsumi i larte dhe mungesa e burimeve alternative krijon probleme gjate dimrit duke shkaktuar ndërprerje dhe tension te larte, duke demtuar aktivitetin ekonomik ne kete zone.

3.3.8 Shendeti

Ne ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise, jane 162 qendra te shërbimit parësor shendetesor ne rajonin ndërkufitar dhe 15 spitale. Sipas analizave te bera nga Instituti Shtetror i Shendetit Publik kjo infrastrukture eshte e pamjaftueshme. Përvec diferencave te rregjistruara ne nivel bashkiak ka nje mungese te dukshme ne termat e paisjes me staf mjeksor ne zonat rurale dhe urbane, si dhe situates ne fshat karakterizuar me mungese ne staf.

Ne Shqiperi, jane 178 qendra shendetsore, 584 klinika ambulatorie, 12 klinika dhe 18 spitale. Sistemi i kujdesit shendetesor raportohet qe mbulon te gjithe nevojat e popullsesise. .

Ceshtjet kryesore nderkufitare lidhur me infrastrukturen:

- Zhvillimi dhe permiresimi i Korridorit VIII si nje mundesi e madhe per te dy vendet
- Permiresimi i rrjetit lokal rrugor si nje shqetësim i perbashket.
- Nevoja per permiresimin e pikave kufitare, vecanerisht ne sherbim te kalimit te mallrave
- Permiresimi i sistemeve te furnizimit me uje, dhe per me teper te sistemit te ujerave te zeza dhe kanalizimeve, menaxhimit te mbetjeve, si prioritetet per te dy vendet.

- Ne te dy vendet ka nje nevoje per te permiresuar aksesin ne internet dhe telekomunikim ne pergjithesi.

3.4 Ekonomi

3.4.1 Te dhena te pergjithshme

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise dhe Republika e Shqiperise jane antare e Marreveshjes se Tregestise se Lire te Europes Qendrore (CEFTA). CEFTA plotëson Marreveshjet e Stabilizim Asociimit per vendet e Ballkanit. CEFTA eshte nje hap përpara drejte nje bashkëpunimi me te ngushte ekonomik qe eshte nje pjese e pashmangshme per antaresine ne BE. Ne kete kontekst ne 2002, Shqiperia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonise kane nënshkruar nje Marreveshje te Tregtise se Lire. Sidoqofte, qellimi i shkëmbimit te mallrave mes dy vendeve eshte ende shume i ulet ne krahasim me shkëmbimet me vendet e tjera fqinje (vetem 1% e totalit te shkëmbimeve te huaja te ish Republikes Jugosllave te Maqedonise). Shkëmbimi ka filluar te shtohet vetem keto vitet e fundit (psh vlere e eksporteve te produkteve ushqimore bujqesore ne 2004 nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonise ne Shqiperi ishte rritur 141 % ne krahasim me 2002).

Treguesit e zhvillimit ekonomik ne nivel te pergjithshem ne zonen nderkufitare ne Shqiperi eshte me e ulet krahasim me nivelin ne rang vendi. Situata eshte me e ndryshme ne Ish Republikën Jugosllave te Maqedonise ku Pelagonia (me Bitola si qendra me e madhe industriale) eshte, pervec Shkupit, rajoni I vetem me GDP per fryme me te larte se niveli kombetar¹⁵. Ne te kundërt me kete Rajoni i Pologut ka nivelin me te ulet te aktivitetit ekonomik ne vend. Qendrat me te medha industriale ne Ish Republikën Jugosllave te Maqedonise jane Bitola, Kicevo dhe Tetovo, dhe Elbasani dhe Korca ne Shqiperi.

Zona nderkufitare mund te karakterizohen si rajone me ekonomi agrare ose inustriale agrare, megjithate ne teresi duhet te merren ne konsiderate ndryshimet e ndjeshme mes rajoneve (mes vendeve, por dhe mes jugut e veriut, dhe mes pjeseve malore dhe fushore) Bujqesia, agribiznesi, industria e lehte, minierat, prodhimi I energjise dhe turizmi jane sektoret kryesore ekonomike, te cialt kane gjithashtu nje potencial te madh ne rajonin nderkufitar.

Sipas shumices se treguesve, trendet ekonomike dhe demografike ne pjesen jugore dhe veriore jane te ndryshme dhe pothuaj te kundërta. Rajonet Veriore (Polog ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonise dhe Dibres ne Shqiperi) jane nder rajonet me te varfra ne te dy vendet ndersa rajonet ne jug (Pelagonia dhe Korca) jane nga me te zhvilluarat. Rajonet qendrore (Southwest dhe Elbasan) jane gati prane mesatares ne rang kombëtar.

3.4.2 Bujqesia dhe zhvillimi rural

Bujqesia mbetet nje sektor dinamik, vecanerisht ne ultesirat e Korces dhe Pelagonise. Pelagonia prodhon 50% te duhanit dhe 45% te grurit te te gjithë ish Republikës Jugosllave te Maqedonise. Prodhimi i frutave eshte aktiviteti me i madh ne te dy anet e kufirit dhe eshte koncentruar me shume ne zonat e nje lartesisë 300 deri 800 metra. Prodhimi i molleve eshte dega me e madhe e prodhimit te frutave (rajoni nderkufitar prodhon rreth 90% te totalit te prodhimit te molleve ne Ish Republikën Jugosllave te Maqedonise). Qershiat dhe thanat, si dhe plums, prodhohen me shume ne pjesen veriore. Prodhimi I arrive eshte me e larte ne Shqiperi. Ne Ish Republikën Jugosllave te Maqedonise fermat e rrushit jane koncentruar me shume ne pjesen jugore te rajonit (Ohrid, Prilep, Bitola and Struga) dhe perfaqesojne rreth 12% te prodhimit kombetar. Pas zhdukjes se fermave bujqesore shteterore ne Shqiperi, pemet e vreshtat pesuan nje shkatërrim total, por prodhimi u rrit me kalimin e viteve. Prodhimi I perimeve dhe te korrurave industriale si dhe blegtoia dhe prodhimeve blegtorale rritet ne dy vendet duke lejuar zhvillimin e industrise se perpunimit.

Sektori bujqesor eshte ne renie ne zonat malore ne pjesen veriore, me pak e favorizuara nga ana gjeografike dhe klimaterike, ku toka per shtepi eshte me pak dhe prodhimi shpesh eshte i orientuar drejt konsumit vetiak. Blektorja, vecanerisht mbareshtimi i dheneve, po rritet dhe behet nje aktivitet dominues ne kete rajon. Ne shume fusha, vecanerisht ne Ish Republikën Jugosllave te Maqedonise, mosha e popullsisë rurale mund te pershpjetoje renien e sektorit bujqesor.

¹⁵ Burimi: Diferencat ne zhvillimin social-ekonomik mes bashkive ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonise, UNDP, 2004

Zonat malore prodhojne produkte te tradites e te cilesise se larte si bylmet dhe mish (djath dele, kaskaval dhe mish qinjgji por edhe disa lloje frutash dhe perimesh si fasule) dhe njihen si te tilla nga konsdhe mbrohen sic duhet nga legjislacioni dhe rregulloret eksistuese, (Marke e mbrojtur origjine, Emer i Mbrojtur Tradite) dhe lidhen me kushtet ereja te tregut, mund te forcojne ne rajon identitetin dhe te nxisin zhvillimin ekonomik te vendit. Roli qe mund te luajne produktet tradicionale te ndryshme ushqimore (si edhe vererat e likernat) duhet te merret ne konsiderat gjate percaktimit te strategjive te turizmit. Pyjet gjithshu perbejne nje aktivitet te rendesishem ne zonat malore. Ato mbulojne 44% te rajonit nderkufitar te ish Republikes Jugosllave te Maqedonise dhe 37% te zones se Shqiperise.

Se fundmi, peshkimi mbetet nje aktivitet qe prodhon te ardhura ne te dy anet e kufirit dhe ndikon ne rritjen e imazhit e ardhur Finally, fishing remains an income generating activity in both countries and pde specifikes se rajonit. Zhvillohet kryesisht ne liqenin e Ohrit dhe Prespes. E ardhmja e ketij aktiviteti duhet te kombinohet me nevojën per ruajtjen e biodiversitetit, psh trofta e Ohrit eshte e mbrojtur rreptesisht ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise.

3.4.3 Industria, minierat dhe energjia

Deri ne fund te viteve 80, qarku i Elbasanit ishte nje nga qendrat me te rendesishme industriale ne Shqiperi dhe vendi i industrise se rende (metalurgji, cemento, industri mekanike). Pjesa me e madhe e ketyre impianteve pushoi se punuari pas 1990 ose po operojne me kapacitet te reduktuar. Sot, industria e lehte eshte dominuese ne zonen nderkufitare ne te dy vendet, koncentrimi eshte me shume ne zonen jugore (Korca dhe Pelagonia). Eshte nje strukture e ndryshme industriale, sektoret te cilet rriten ne menyre te ndjeshme jane industria e perpunimit ushqimor, prodhimi tekstil dhe ndertimi. Prodhimi i tekstileve eshte ne nje pprogres konstatnt ne te dy anet e kufirit, si pasoje me teper e investimeve greke dhe sipermarrjet e perbashketa. Aty punesohen nje numer i konsiderueshem punetoresh, vecanerisht gra, dhe ne disa zona eshte burimi kryesor i punesimit. Industrite e perpunimit ushqimor jane vecanerisht dinamike ne Bitola (vendodhja e fabrikave me te medha te perpunimit ushqimor ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise) dhe Korca. Ato merren me prodhimin e bulmetit, perpunimit te mishit, konservimi i frutave dhe perimeve, prodhimi i birres dhe alkolit, aktivitet i cile eshte rivitalizuar kohet e fundit ne Korce. Industria ushqimore siguron per tregjet vendase, megjithese disa produkte kane filluar te eksportohen. Megjithate mangesite ne paraqitje (peketim, strategji marketingu etj) dhe sistemi i varfer i marketimit konsiderohen shpesh nje pengese ne zhvillimin e sektorit ushqimor. Ndertimi eshte nje tjetër sektor i cili eshte shtrire kohet e fundit, paralelisht me bumin ne ndertimet private, duke u bere nje nga sektoret ne te rendesishem te punesimit ne vend (ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise ky aktivitet eshte vecanerisht i koncentruar ne rajonin e pologut ku numeri i banesave eshte rritur me 33% nga 1994 ne 200216).

Rajoni nderkufitar eshte i pasur me burime nentoksore te cilat jane ende ne zbulim. Rajonet e Korces, Dibres dhe Elbasanit ne Shqiperi jane te njohura per qymyr, hekur, baker asbes, rere kuarcore, krom, materiale ndertimi dhe gure dekorative. Aktualisht Dibra eshte zona me e pasur minerare ne vend (qymyr dhe krom). Dy miniera per hekur dhe nikel dhe dy te tjera per baker jane ne rajonin e Korces. Ka gjithshu dhe dy burime rere kuarci e perdorur ne industrine e xhamit dhe ne fonderi. Ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, zona nderkufitare siguron rreth 95% te prodhimit te vendit me qymyr, qe perdoret kryesisht ne dy termocentrale ne rajon (Bitola dhe Oslomej). Hekuri nxirret ne Debar (rajoni Polog) dhe mermeri ne Prilep (Pelagonia).



Prodhimi i energjise, si dhe e ujit mineral dhe industrise se drurit, jane gjithashtu vlera per rajonin nderkufita, vecanerisht ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise (dy termoncentralet kryesore te vendit jane te vendosura ne rajonin nderkufitar, si dhe 5 hidrocentrale).

3.4.4 Sektori i SME-ve

Ne ish-Republikën Jugosllave te Maqedonisë zona ndërkuftare përbehet nga 56 356 sipërmarrje te regjistruara ose 32% te te gjitha ndërmarrjeve ne vend. Pjesa me e madhe e tyre janë te vogla ne madhësi (36% kane vetëm një punëtor) dhe me shume se gjysma e tyre operojnë ne sektorin e tregtisë. Kompanitë e përpunimit ushqimor (përfshirë fabrikat e birrës) janë koncentruar me tepër ne



¹⁶ Burimi: Diferencat ne zhvillimin social-ekonomik mes bashkive ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, UNDP, 2004

Pelagonia, ndërsa kompanitë e transportit dhe ndërtimit janë dominuese ne rajonin e Polog dhe Southwest. SME-te e rajonit ngrënë problemin e kapaciteteve investuese dhe aksesin për kredi si pengesa serioze, e cila te çon drejt një teknologjie te vjetruar, mungese vizioni dhe diferencim produktesh (sistemi parketimi është i pazhvilluar) dhe infrastrukture transporti te pamjaftueshme (sidomos hekurudha).



Burimi: Diferencat ne zhvillimin social-ekonomik mes bashkive ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, UNDP, 2004

Ne Shqipëri, numri total i SME-ve jane aktive ne zonen nderkufitare perbejne vetem 17% te te gjitha SME-ve ne Shqiperi. Me shume se gjysma e tyre jane te vendosura ne Korce. Pjesa me e madhe e bizneseve operojne ne fushen e tregtise (45%), shërbimeve dhe transportit. Pjesa dominuese e bizneseve ne te tre rajonet jane te vogla ne madhesi, karakterizohen me shume si biznese familjare, duke ofruar pak mundesi per punësim. Përgjithësisht këto biznese janë te organizuara dobet dhe nuk kane teknologji moderne apo teknika menaxhimi koherente. Keto biznese kryejne investime te pakta pa baze qëndrueshmërie afatgjate. Gjithashtu, biznesi jobujqësor lufton me infrastrukturen e dobet, ndërprerjet e energjisë, dhe kostot e larta te ngritjes se biznesit etj. Numri i aktiviteteteve ne 2005 krahasim me 2003 eshte rritur rreth 20% ne nivel rajonal. Rritja me e madhe vihet re ne Rajonin e Dibres me 29%, ndjekur nga Elbasani me 24 % dhe Korca me 19%.



Ne te dy vendet, ndërmarrjet janë te keq organizuara dhe lidhura edhe brenda te njëjtit sektor. Shume pak shoqata përfshijnë vetëm një numër te vogël ndërmarrjesh.

3.4.5 Turizmi

Turizmi eshte potenciali kryesor per zhvillimin e rajonit nderkufitar dhe synimi kryesor per pjesen me te madhe te investitorëve, vecanerisht ne pjesen jugore te rajonit. Te gjitha rajonet e prekura

nga programi kane potenciale individuale per zhvillimin e aktiviteve turistike, mes te cilave mund te përmendim: panorama dhe natyra atraktive, parqet kombetare, atraktiviteti i liqeneve (liqenet e Ohrit dhe te Prespës, por dhe liqenet malore) dhe zonat e famshme historike, mundësi për te zhvilluar sporte dimërore dhe malore, stacione ekzistuese te skive ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë (Popova Shapka, Mavrovo, Krushevo, Oteshevo dhe Pelister), qendrat ekzistuese te kurimeve termale ne te dy anët e kufirit (Debar dhe Kosovraska ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë, Peshkopi ne Shqipëri), etj. Prezenca e Aeroportit te Ohrit, e specializuar per fluturimet charter, si dhe afërsia e aeroportit te Shkupit me ate te Tiranës për pjesën veriore është nje vlere e çmuar shtese. Afërsia me Greqinë gjithashtu ofron mundësi për te zhvilluar turizmin ne zonat e thella. Sidoqoftë, industria e turizmit nuk ka te njëjtin nivel zhvillimi ne Shqipëri dhe ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonisë.

Ne ish-Republikën Jugosllave te Maqedonisë, totali i turistëve qe kalojne naten ne rajonin ndërkufitar 20 2005 ishte 1 517 425 (nga te cilet 1 284 964 vizitore vendas dhe 232 461 te huaj). Ajo perben 77% te sasise se turistëve qe kalojne naten ne vend dhe nje rritje prej 73% krahasuar me 2001. Aktivitetet dhe infrastrukturat turistike jane kryesisht te koncentruara ne pjesen jugore, por edhe pjesa veriore ofron potenciale te medha dhe duhet te perfitoje gradualisht nga dinamizmi i arritur ne jug. Megjithese infrastruktura ekzistuese duhet te permiresohet, shqetësimi i Ish Republikës Jugosllave te Maqedonise eshte jo vetem te rrise numrin e vizitoreve por dhe te organizoje punen ne menyre te tille qe te mos demtoje burimet natyrore.

Situata ne Shqipëri eshte totalisht ndryshe. Niveli i turizmit ne zonen nderkufitare (me nje përjashtim te lehte te Pogradecit) eshte simbolik, gje qe eshte rezultat i nje numri faktoresh si: demtimi i pyjeve, kaosi urban, infrastruktura e dobët (rrugët, energjia, uji, shendetesia), problemet mjedisore, cilësia e dobët dhe ne pergjithesi niveli i ulet i shërbimeve dhe standardeve te akomodimit, parketimi joprofesional dhe mungesa e informacionit dhe guideve turistike.

Ceshtjet kryesore nderkufitare lidhur me ekonomine:

- Nivel i ulet i shkëmbimeve ekonomike dhe tregtare mes vendeve: programi ndërkufitar nuk ngrihet mbi bazen e nje tradite solide te shkëmbimeve dhe partnershipeve, por ndërhyr per fillimin e këtij procesi.

- Interesi i perbashket per mbrojtjen e prodhimeve tradicionale bujqesore dhe te zonave te thella.

- Zhvillim jo i njejte i industrise se turizmit dhe mundesi per transferimin e pervojës dhe praktikave pozitive nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonise ne Shqipëri..

- Interes i perbashket per mbështetjen dhe organizimin e furnizimit e SME-ve.

- Interes i perbashket per zhvillimin e burimeve alternative te energjise

3.5 BURIMET NJEREZORE

3.5.1 Arsimi, Kerkimi dhe Zhvillimi

Ne ish-Republikën Jugosllave te Maqedonisë, zona nderkufitare eshte e mbuluar mire me sherbim arsimor. Jane 444 shkolla fillestare me 93 358 studente dhe 37 shkolla te mesme me 35 676 studente. Arsimimi i komuniteteve etnike eshte nje e drejte kushtetuese si per arsimimin fillestar dhe ate te mesem.

Gjithashtu, ka edhe disa qendra universitare publike dhe private: ne Tetovo (nje universitet privat me shtate fakultete dhe nje Universitet publik me pese fakultete), ne Bitola (pese fakultete), ne Oher (fakulteti i Turizmit) dhe ne Prilep (Fakulteti i Ekonomise).

Kerkimi shkencor kryhet nga Fakultetet dhe institucionet kerkimore si Instituti Biologjik ne Oher, Instituti i Duhanit ne Prilep, dhe agjenci kërkimi bujqësor ne Bitole. Per te stimuluar fillimin e aktiviteve te biznesit, jane ngritur ne zonen nderkufitare (Bitola) inkubatorë dhe parqe shkencore.

Analiza SWOT e kryer ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonise per qellim te Programit Operacional shumevjecar IPA Komponenti IV (zhvillimi i burimeve njerezore) përmend problemet ne arsimimin e te rriturve dhe Trajnimin e Arsimimin Profesional (VET) si dhe lidhjet e pamjaftueshme mes Kerkimit e Zhvillimit dhe komunitetit te biznesit. Ky përfundim eshte i njejte per te dy vendet.

Ne Shqipëri periudha transitore ka pasur nje ndikim negativ ne sistemin arsimor. Vecanerisht ne zonat nderkufitare dhe te thella ka probleme te medha lidhur me sistemin arsimor. Si pasoje nje numer treguesish arsimore jane perkeqesuar. Mbyllja e shkollave, mungesa e materialeve shkollore, shkatërrimi i infrastruktures shkollore, mungesa e investimeve, fondeve, furnizimit me libra shkollore

dhe mësuesia e pakualifikuar janë vetëm disa nga problemet kritike që kanë cuar në krijimin e një sistemi jociësor arsimor, vecanerisht në zonat malore të rajonit ndërkufitar. Janë 474 shkolla fillore në të tre rajonet dhe 112 shkolla të mesme. Nga këto 17 shkolla janë profesionale, 2 nga të cilat 2 ndodhen në rajonin e Dibres, 6 në Elbasan dhe 9 në Korce. Korce dhe Elbasani kanë universitet publik. Gjate dhjetëvjeçarit të kaluar, frekuentimi i shkollave ka pësuar rënie në zonat malore, si pasojë e distancës së gjatë, infrastrukturës së keqe rrugore, kushteve të keqja në shkolla dhe varferisë. Rreth 40% e shkollave në Diber dhe Mat dhe 35-55% të shkollave në Elbasan janë në kushte shumë të rënda fizike dhe kanë nevojë urgjente për investime kapitale. Situata është pak më e mirë në Korce.

Ceshtjet kryesore ndërkufitare lidhur me arsimin dhe kërkimin

- Zhvillimi i arsimit të të rriturve dhe arsimimit dhe trajnimit profesional VET si shqetësim i përbashkët i të dy vendeve.

- Megjithatë situata në Shqipëri është më e rëndë, nevoja për të përmirësuar infrastrukturën arsimore në zonat rurale dhe malore është shqetësim i përbashkët

- Përmirësimi i aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimore në universitetet e vendosura në rajonin ndërkufitar dhe ose lidhja e tyre me komunitetin e biznesit duhet të jetë një ceshtë ndërkufitare. Me përgjithësisht, prezencë e universiteteve në të dy anët e kufirit konsiderohet një vlerë e çmuar për zhvillimin dinamik të rajonit. Universitetet duhet të inkurajohen të marrin pjesë në programin ndërkufitar.

3.5.2 Tregu i punës dhe varferia

Të dhënat zyrtare mbi punësinë dhe papunësinë në zonën ndërkufitare nuk lejojnë krahasimin e situatës, pasi metoda vlersimit është i ndryshëm për të dy vendet, Norma e papunësisë raportohet 13% në Shqipëri, ndërsa është më shumë se 40% në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ndryshimi nuk reflekton situatën reale dhe duhet të vijë nga papunësia e pamatur në Shqipëri, niveli i ulët i regjistrimit të personave të papunësuar dhe mbivlerësimi i normës së punësimit në sektorin bujqësor. Nga ana tjetër në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, për arsye se Instituti i Punësimit siguron sigurimin shëndetësor të personave të papunësuar, të dhënat zakonisht janë më shumë se situata faktike. Ka shumë mundësi që norma e papunësisë të jetë pak a shumë e ngjashme për të dy vendet dhe duhet të jetë edhe më e ulët në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, e cila përfiton nga përqendrimi më i madh i bizneseve dhe industrive (përfshirë industrinë e turizmit).

	Forca aktive e punës	Norma e Papunësisë %	Norma e punësimit %
Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ¹⁷	743,676	38	34
Pelagonia	104,016	40	40
Southwest	68,789	42	28
Polog	71,089	50	19
Shqipëri ¹⁸	1,085,359	14.1	85.9
Elbasan	131,279	12.8	87.2
Korce	85,323	11.2	88.8
Diber	56,745	16.5	83.5

Të dhëna të përgjithshme

Papunësia është më e lartë në pjesët veriore të rajonit ndërkufitar (rajoni i Pologut ka normën më të lartë të papunësisë në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe norma e papunësisë në rajonin e Dibres është më e lartë se mesatarja kombëtare). Këto janë rajone ku bujqësia është në rënie dhe pjesa më e madhe e bashkive është e vendosur në vende të pafavorshme malore-rurale. Në pjesën

¹⁷ Burimi: Diferencat në zhvillimin social-ekonomik mes bashkive në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, UNDP, 2004.



¹⁸ Burimi: Tregues nga Prefekturat 2004-2005.

veriore, norma e papunesise eshte prane mesatares kombetare ose ne rastin e Shqiperise me e ulet.

Ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, norma e papunesise varion mes grupeve te ndryshme etnike mes me te ultes - 25,3% ne popullesine Vlach (vllahe) (grupuar ne qendrat kryesore urbane duke ofruar raste me te mira punësimi) dhe me te lartes- 78,5 % te popullesise Rome, gje qe lidhet me nivelin e arsimit dhe kushteve te tyre te jeteses. Shqiptaret kane gjithashtu nje norme te larte papunësie, si pasoje e faktit te përqendrimit te tyre ne zona rurale malore me nje nivel te ulet aktiviteti ekonomik.

Norma e papunesise tek te rinjte eshte e larte ne te dy vendet (me shume se 75% ne sih Republiken Jugosllave te Maqedonise).

Sipas te dhenave zyrtare, ndarja e papunesise sipas sektoreve ekonomik eshte si me poshte:



Source: 'Socio - Economic Disparities among Municipalities in the former Yugoslav Republic of Macedonia', UNDP, 2004

Ne Shqiperi, norma e papunesise ne sektorin bujqësor ka shume mundesi te jete mbivlerësuar (numeri i madh i forces se fines ne ferma shume te vogla). Gjithashtu del se përqindja e aktivitetit te grave eshte shume i ndryshem ne te dy vendet. Rajoni Polog ka nje aktivitet te grave prej 18%, i cili eshte prane përqindjes se këtij aktiviteti ne Shqiperi, ndersa ky tregues eshte ne Pelagonia 55%.

Varferia

Norma e varferise duket te jete me e larte ne rajonin ndërkufitar se ne rajonet e tjera ne te dy vendet. Ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, përqindja e shtëpive qe përdorin Fondin e Asistences Financiare eshte 14,7% e te tere vendit, nga e cila 17,4% ne rajonin e Pelagonia, 14,8% ne Southwest dhe 20,9% ne rajonin Polog.

Ne baze te "Hartes se Varferise dhe Pabarazise" rajoni i Dibres ka pjesen me te madhe te popullesise se varfer ne vend. Përqindja e kësaj popullesise ne kete rajon eshte 42,77% te totalit te popullesise, cka do te thote qe gati nje ne dy perona eshte i varfer.

Perfshirja sociale

Ka nje mungese koherence dhe analize te situates aktuale ne zonen nderkufitare persa i perket përfshirjes sociale, vecanerisht ne termat e përfshirjes se grupeve ne nevojë ne keto shërbime.

Brenda objektivit te gjere te përfshirjes se te drejtes njerezore per reduktimin e varfërisë, bazuar ne menyre eksplicite ne norma dhe vlere te vendosura nga institucione ndërkombëtare te te drejtave te njeriut, Programi duhet te merret me zhvillimin e politikave dhe çeshtjeve te përfshirjes sociale ne nivel lokal dhe rajonal, duke promovuar pjesëmarrjen dhe përqasjen e bashkëpunimeve.

Ceshtjet kryesore nderkufitare lidhur me tregun e punes

- Papunesia, dhe vecanerisht e te rinjve, eshte nje problem i madh social per te dy anet e kufirit.

- Ne te dy vendet, situata sociale e zones nderkufitare eshte e ndryshme: ne zonat nderkufitare bejne pjese me te varfrit por njekohesisht dhe rajonet me te zhvilluara. Persa i perket aspekteve sociale, prioritetet do te ndryshojne nga nje rajon ne nje tjetër.

- Pjesmarrja e grave ne tregun e punes eshte shume e ndryshme mes dy vendeve dhe gjithashtu mes pjesëve veriore dhe jugore te rajonit ndërkufitar.

3.6 Mjedisi dhe natyra

Zona nderkufitare eshte shume e pasur me biodiversitet dhe burime natyrore. Mbrojtja dhe pasurimi i ketyre vlerave ehte sigurisht nje nga pikat kryesore per zhvillimin e qendrueshem ne rajon. Institucionet lokale kane shqetesim ne rritje te ardhmen e ketyre burimeve.

Ne te dy vendet, zonat e mbrojtura jane klasifikuar ne gjate kategori ne perputhje me kriterin e Bashkimit Boteror i Mbrojtjes se Mjedisit (IUCN).

Zonat e mbrojtura ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, perfshijne 81 zona qe mbulojne respektivisht rreth 7,4 % ote te tere territorit dhe pjesa me e madhe e ketyre zonave eshte e shtrise ne rajonin ndërkufitar (153 523 ha).

Ne rajonin ndërkufitar jane krijuar 22 zona te mbrojtura: dy rezervate natyrore (kategoria I) Ezerani (i krijuar ne 1996, mbulon pjesen veriore te bregut te Liqenit te Prespes, me rreth 200 specie zogjsh, perfshire paten e eger, pelikanin, moorhen vendi dhe eshte e perfshire ne Listen Boterore Ramsar. Dhe Lokvi; tre parqe kombetare (kategori II) : Parku Kombetar i Mavrovos (vendosur ne 1949) qe mbulon nje hapësire prej 73 100 ha, Parku Kombetar i Galicica qe mbulon nje hapësire prej 22 750 ha mes Liqenit te Ohrit dhe Prespes, Parku Kombetar i Pelister (krijuar ne 1948) qe mbulon nje hapësire prej 12 500 hektare; dhe 17 zona (kategori e III) me me te rendesishme: dy liqenet tektonike te Ohrit dhe Prespes mbrojtur si Monumete Natyrore ne 1977 (liqeni i Ohrit mbulon nje hapësire prej 23.000 ha, dhe liqeni i Prespes 17.680 ha). Liqeni i Ohrit eshte i perfshire ne Listen e UNESCO te trashegimise boterore ne 1979. Zona hidrologjike Vevchanski Izvori (Vevchani Springs) u quajt Monument Natyre ne 1999.

Zona nderkufitare gjithashtu eshte perfshire ne nje sere aktivitetesh e iniciativash per zhvillimin e rrjetit ekologjik. Rrjeti Kombetar Emerald ne kete moment perfshin 16 zona te nje interesi te vecante per mbrojtje si: NP Mavrovo, Shar Planina, NP Galichica dhe SNR Ezerani. Vija e Gjelber Ballkanike perfshin te tera zonat e mbrojtura te lartpërmendura.

Ne zonen nderkufitare shqiptare, 91 358 ha ajne te mbrojtura nga nje nga kategorite e IUCN. Zona perbehet nga nje rezervat natyror (kategori I), Rrajcë (4 700 ha), ne rajonin e Elbasanit dhe 4 parqe kombetare (kategoria II): Lura dhe Zall Gjoçaj ne Diber, Bredi I Drenovës dhe Prespa (27 750 ha) ne Korce. 269 zona te tjera mbrohen nga kategoria e trete dhe e katert e IUCN, duke perfshire pjesen shqiptare te liqenit te Ohrit.

Harta treguese e Rrjetit Ekologjik Pan-European Ecological (PEEN) ne Europen Jug-Lindore paraqet zonen nderkufitare si korridori kryesor per disa specie migratore qe duhet te mbrohen..

Ne ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise, mjedisi eshte i rrezikuar nga menaxhimi i dobet e ujerave dhe sistemit te ujerave te zeza, dhe urbanizimit te pakontrolluar dhe presionit te aktivitetit te turizmit dhe aktiviteteteve industriale, te cilat jane ende ne nivel te ulet ne pjesen me te madhe te zonave te mbrojtura. Per me shume, ndotja industriale ka shkaktuar deme te medha mjedisore ne Shqiperi, vecanerisht ne Elbasan.

Mbrojtja mjedisore dhe menaxhimi i vlerave natyrore jane fusha ne te cilat te dy vendet kane filluar te vendosin nje bashkëpunim intensiv ndërkufitar. Me iniciativat qe po behen ne kuadër te Projektit per Mbrojtjen e Liqenit te Ohrit dhe Projektit te Parkut Transkufitar te Prespes (qe perfshin edhe Greqine), pjesa jugore e rajonit ndërkufitar mund te behet nje model i menaxhimit te ujerave transkufitare dhe burimeve natyrore.

Ceshtjet kryesore ndërkufitare lidhur me mjedisin

- Mbrojtja dhe pasurimi i burimeve natyrore eshte prioritet per te dy vendet.
- Mbrojtja e liqeneve dhe lumenjve është një baze e mire per bashkëpunimin nderkufitar
- Ndërgjegjësimi për ambientin duhet te përmirësohet ne te dy vendet
- Deri tani iniciativat me te përparuara te bashkëpunimit ndërkufitar mes dy vendeve jane te lidhura me heshtjet ambientale.

3.7 Kulture

Karakteristika unike shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale karakterizojne rajonin ndërkufitar

Trashëgimia kulturore, e prekshme dhe jo e prekshme dëshmon mbi krijimtarine njerezore dhe

krijon themelin e identitetit të rajonit ndërkufitar. Trashëgimia kulturore përfaqëson një nga vlerat më të rëndësishme për zhvillimin e rajonit Nderkufitar. Ajo mund të ofrojë mundësi punësimi, promovim të kultures dhe trashëgimise dhe turizem.

Ministria e Kultures në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonise liston rreth 850 zona arkeologjike në tre rajonet statistikore. Liqeni i Ohrit dhe Ohri u pranuan nga UNESCO si Zona të Trashëgimise Botërore në 1980. Pjesa jugore është vecanerisht e njohur për përqendrimin e monumenteve historike, kishave, manastireve (manastiri i Shen Naumit, Kisha Mesjetare e Shen Sofies etj) dhe afreskot që datojnë nga epoka klasike në shekullin XIX. Disa monumente të tjera të çmuara janë të vendosura në pjesën qendrore dhe veriore dhe dëshmojnë influencën ndërkulturore të traditës myslimane dhe kristiane në rajon (psh manastiri St Jovan Bigorski afër Debar, Manastiri i Lesho, “xhamia e pikturuar” dhe Teqeja e Dervishit në Tetovë etj). Rajoni i Korces në Shqipëri ka Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar Shqiptar dhe 7 muze kombëtare në anën e Ish Republikën Jugosllave të Maqedonise.

Aktivitetet dhe festivale të shumta kulturore janë organizuar në rajon, vecanerisht gjatë verës, ku disa edhe me natyrë ndërkufitare (si dita e Liqenit, organizuar në Korrik nga qyteti i Pogradecit në Shqipëri dhe qytetet e Ohrit e Struges në ish Republikën Jugosllave të Maqedonise dhe festivali “Oda Dibrane” në Shqipëri ku paraqiten artiste nga të dy anët e kufirit). Përvec Ohrit, i frekuentuar shumë nga turizmi, (festivali i muzikës “Summer of Ohrid” është vecanerisht i njohur), disa qytete si Prilep (quajtur qyteti i kultures 2007 nga Ministria e Kultures), Struga (festivali i poezisë) dhe Bitola (festivali i muzikës klasike, classical, festivali Video-art, festivali ndërkombëtar i filmit amator dokumentar) kanë një jete aktive dhe atraktive kulturore. Me hapjen e institucioneve të arsimit të lartë, Tetovo është gjithashtu në rrugën për të bërë një qendër të rëndësishme kulturore në rajonin e Pologut.

Si përfundim, rajoni është i pasur në traditën e guzhines dhe punimit me dorë. Këto tradita mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e turizmit të rajonit por janë ende të pavlerësuara. Pak NGO, vecanerisht NGO për gratë, në të dy anët e kufirit kanë filluar vlerësimin dhe ruajtjen e këtyre vlerave kulturore.

Zona e Programit është e vendosur mbi gjuhët: Maqedonase, Shqiptare, Turke, Vlahi dhe Roma. Ndergjegjësimi për rëndësinë e njohjes së kultures së fqinjëve është në rritje dhe mund të çojë në intensifikim të bashkëpunimit kulturor.

Bashkëpunimi ndërkufitar në fushën e Medias (radio, TV, dhe media të tjera audio-vizuale, media e shkruar dhe elektronike), ka zbuluar shumë pak potencialin bashkëpunues dhe mund të kontribuojë në përhapjen e perspektivës së bashkëpunimit ndërkufitar, për të kuptuar më mirë diferenca dhe ngjashmeritë kulturore të zonës së programit dhe të paraqesë pasurinë e kësaj kulture në audiencat e gjera evropiane.

Ceshtjet kryesore ndërkufitare lidhur me kulturën

- Kultura e të dy vendeve është potencialisht e pasur, të ndryshme por komplementare dhe ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar.

- Të dy vendet kanë interes në ruajtjen e autenticitetit dhe diversitetit të kultures.

- Trashëgimia kulturore dhe natyrore duhet të pasurohet më tej me qellim forcimin e identitetit rajonal.

3.8 Zhvillimi institucional

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise ka krijuar një sistem me një nivel të qeverisjes lokale bazuar në bashki. Territori i vendit është i ndarë në 84 bashki. Qyteti i si zone metropolitane ka një status të veçantë. Në cilësinë e kompetencave të tyre bashkime mund të bashkëpunojnë mes tyre, të krijojnë fonde të përbashkëta, të ngrenë agjenci publike të përbashkëta dhe institucione administrative në disa fusha dhe sektore. Ka një Shoqatë Kombëtare të Njësive të Vet QeverisjeS Vendore, (ZELS), e cila ka një influencë pozitive në ngritjen e demokracisë lokale. .

Bashkitë mund të koprojnë me njësistë e vet-qeverisjes vendore të shteteve të tjera dhe mund të behen antare të organizmave ndërkombëtare të qeverisë vendore.

Ligji i ri i Zhvillimit Rajonal, miratuar në Maj 2007, është baza për ngritjen e strukturave institucionale për zhvillimin rajonal. Këto struktura të reja mund të vendosen në 8 rajone (NUTS kategoria 3): Pelagonia, Vardar, Northeast, Southwest, Skopje, Southeast, Polog dhe rajoni East .

Shqipëria ka një strukturë tjetër administrative. Vendi është i ndarë në 12 qarqe, që përfshin

36 qytete. Qytetet ne vetvete jane te ndara ne bashki (qendrat urbane) dhe komuna (territoret rurale). Zhvillimi rajonal dhe lokal është celesi i procesit te reformave te decentralizimit ne Shqiperi. Roli i Këshillit te Qarkut per koordinimin e aktivitetit te zhvillimit ne qarqet respektive eshte rritur, paralelisht me transferimin e pushtetit ne nivelin lokal per shërbimet publike. Reformat fiskale te kohëve te fundit, kane si qellim dhenjen e autoritetit te plote njesive te qeverisjes vendore per taksen mbi biznesin e vogël dhe pritet te paraqesin kuadrin ligjor te huamarrjes se bashkive, duke i dhene me shume liri njesive te qeverisjes vendore drejt programve te zhvillimit.

Ne te dy vendet Dhomat e Tregtise, Agjencite e Zhvillimit Rajonal, si dhe Qendrat per Zhvillimin e Planifikuar te Rajoneve ne anen e Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise do te jene aktore te mëdhenj ne nxitjen e bashkëpunimit ndërkuftar. Sektori i NGO-ve nuk eshte shume i njohur per rolin e tij ne zhvillimin ekonomik dhe social te rajonit nderkuftar. Sidoqoftë, eshte e qarte qe ky rol do te rritet dhe gjithashtu qe ka hapësire ne rajonin ndërkuftar per zhvillimin dhe permiresimin e numrit dhe kapaciteteve te NGO-ve. NGO-te kryesore ne te dy vendet jane te përqendruara ne pjesen jugore te rajonit ndërkuftar. Mungesa e organizimit te shoqatave ne disa fusha mund te jete nje pengese per pjesëmarrjen e shoqerise civile ne programin ndërkuftar. Dy qendra per mbështetjen e NGO-ve (projekte donatorësh) jane (vendosur ne zonen nderkuftare te ish Republikes Jugosllave te Maqedonise (Kicevo dhe Resen) dhe mund te luajne nje rol ne zbatimin e programit ndërkuftar.

Ceshtjet kryesore ndërkuftare lidhur me zhvillimin institucional

- Ngritja e sistemit territorial dhe administrativ nuk eshte e njejte per te dy vendet, gje qe mund te komplikojë ngritjen e nje partneriteti te balancuar mes njesive te qeverise vendore.

- Forcimi i rrjetit te NGO-ve ne rajonin ndërkuftar eshte nje shqetësim i perbashket.

- Permiresimi i shkëmbimit mes enteve ekonomike, agjencive te zhvillimit dhe dhomave te tregetise duhet te trajtohet si ceshtje nderkuftare.

- Strukturat ekzistuese, sic eshte ajo e vendosur per Eurorajonin Prespa-Ohrid, duhet te shoqerohet me zbatimin e programit.

3.9 Analiza SWOT e zonave perfituese

Analiza SWOT e rajonit ndërkuftar u krye me konsultimin e autoriteteve kryesore kombetare, rajonale dhe lokale ne te dy vendet. Ajo eshte bazuar ne:

- Te dhena dhe analiza ne dokument ekzistues, vecanerisht: analiza SWOT e rajoneve statistikore te Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise, e perfshire ne Planin e Zhvillimit Kombetar 2007-2009 (Qeveria e Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise 2007); Diferencat socio-ekonomike mes bashkive ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise (UNDP, 2004), Bashkepunimi Nderkuftar i Biznesit ne Rajonin Prespa-Ohri (EastWest Institute, 2006).

- Te dhena fillestare jane te siguruara nga Instituti Kombetar i Statistikave ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, Instituti Kombetar i Statistikave ne Republiken e Shqiperise, Ministrite dhe Agjencite Shtetore ne te dy vendet autoritetet rajonale dhe Bashkite.

- Intervista me autoritete lokale te kryera ne te dy vendet ne periudhen Shkurt-Mars 2007. Bazuar ne nje pyetësor ad-hoc, rreth 130 intervista u bene ne te dy vendet (autoritetet e qarkut dhe bashkive, sipërmarres, NGO, Dhoma Tregtie, universitete lokale).

- Te dhena shtese dhe sugjerime te marra nga autoritete lokale ne workshopin rajonal ne MAJ 2007 dhe nga Strukturat Operuese ne te dy vendet ne takime te ndryshme te mbajtura ne Mars-Prill 2007.

- Analiza SWOT përmbledh trendin kryesor te rajonin ndërkuftar duke siguruar bazen per përcaktimin e strategjise. Ajo eshte e bazuar ne:

- Pikat e forta dhe vlerat mbi te cilat mund te ngrihet zhvillimi i metejsheh rajonal;

- Limitet dhe pikat e dobta qe rrjedhin ne kontekstin lokal, te cilat mund te frenojne zhvillimin e rajonit.;

- Mundesite, te cilat mund te realizon duke mbikaluar pikat e dobta respektive;

- Risqet e faktoreve te jashtem, te cilat mund te demtojne zhvillim e metejsheh te rajonit.

Analiza SWOT eshte kryer ne nje kuadër te veçante te programit ndërkuftar. Ajo përcakton aspektet dhe sektoret qe mund te influencojne ose mund te influencohen nga Programi. Ajo nuk përcakton problemet dhe sektoret qe mund te mbulohen veshtiresisht nga Programi (psh infrastruktura e rende, te korrat industriale ne sektorin bujqësor etj.).

Analiza SWOT u krye paralelisht ne te dy vendet. Rezultatet e secilës analize me pas u konsoliduan ne permbledhesen me poshte. Ia vlen te përmendim qe trendet dhe zbulimet jane jo vetem te ndryshme nga nje vend ne tjetrin por edhe mes rajoneve përfituese te secilit vend. Kjo permbledhese reflekton diferencat dhe mospërputhjet, te cilat duhet te mbahen ne konsiderate gjate zbatimit te programit.

Me se fundmi, duhet te vihet re qe ish Republika Jugosllave e Maqedonise eshte e bazuar ne rajone statistikore, te cilat nuk jane ende njesi territoriale nga pikëpamja administrative dhe politike. Banoret nuk duhet domosdoshmerisht te ndihen sikur jetojne ne nje rajon statistikor dhe mund te kene nje tjetër perfaqesues te asaj cka territori i tyre eshte. Kjo mund te jete baze qe duhet te kihet ne konsiderate (kur nje person jeton ne Struge dhe thote “rajoni im”, ai/ajo nuk duhet domosdoshmerisht ti referohet Rajonit Statistikor Southwest).

PIKAT E FORTA	DOBESITE	MUNDESITE	RREZIQE
I. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL			
- Marreveshjet ekzistuese te tregetise se lire, marreveshjet bilaterale, si dhe marreveshjet e perbashketa per mirembajtjen e liqeneve te Ohrit dhe te Prespes; - Veprimtarite e procesit decentralizues qe sigurojne veteqeverisjen lokale me mundesine per te percaktuar dhe zbatuar politikat dhe matesit e zhvillimit lokal; - Eksperienca ekzistuese ne modifikim dhe zbatim te programeve te perbashketa dhe te projekteve nderkufitare, neper rajonet e euro-s dhe ne programet e mirembajtjees se liqeneve etc.; - Ekzistenca e nje rrjeti NGO me eksperience ne iniciativat e kooperimit nderkufitar.	- Ndryshimet midis rajoneve dhe bashkive ne fushen e zhvillimit ekonomik e social. Zhvillimi i pabarabarte urban / rural; - Veteqeverisjet lokale te nenzhvilluara dhe te papajisura per shkak te nje procesi te ngadalshem te decentralizimit dhe te transferimit te autoritetit dhe te pasurive nga niveli qendror ne nivelin lokal; - Kapacitetet e limituara humane per shkak te emigrimit te stafit te kualifikuar per ne qendrat urbane dhe kryeqytetet; - Burimet publike te pamjaftueshme per investime publike; - Perfituesit potencial nga sektori privat dhe publik kane kapacitete te limituara ne identifikimin dhe pergatitjen e projekteve, planifikimin strategjik dhe zbatimin e projekteve.	- Mundesia per te pershpjettuar procesin e integritit institucional dhe ligjor ne standartet dhe rregullat europiane do te sjellin si administrimin e sistemeve nga afer po ashtu edhe do te rrisin kompetencat e tyre.; - Mundesia per te zhvilluar mekanizma te ndryshem dhe instrumenta te drejtuar per te thjeshtezuar vendosjen e bashkepjesemarrjes ne iniciativa nderkufitare; - Mundesia per te rritur kapacitetin e organizimit te shoqerise civile dhe kooperimin midis sektorit privat dhe administrates publike ne te dyja anet e kufirit.	- Procesi i ngadalsuar i decentralizimit dhe transferimi i autoritetit nga niveli qendror ne nivelin; - Zbatimi i politikave te shtrenguara fiskale dhe varesia e vazhdueshme nga buxheti shtetit demton kapacitetet e njesive te qeverisjes vendore.
II. INFRASTRUKTURE DHE VENDODHJA GJEORAFIKE			
- Infrastruktura transporti relativisht te zhvilluar (rruget – autostradat dhe rruget rajonale, hekurudhat, rruget ujore, aeroporte; - Ekzistenca e infrastrukturave te turizmit (lehtesirat e akomodimit, ushqim dhe katering, sport); - Vendodhja e favorshme gjeorafike ne koridorin kryesor “8” te transportit (Lindje-Perendim); - Rritja e fluksit te trafikut ne pese pikate kalimit kufitar ne vitet e fundit dhe plan per hapjen e nje pike te re	- Zhvillimi i pabarabarte i infrastrukturave baze ne Shqiperi dhe ne ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, vecanerisht elektricitet, ujesjelles, infrastrukture transporti dhe komunikimi. - Perkeqesimi i infrastrukturave lokale (rruge lokale, sisteme ujesjellesi, kanalizime)si pasoje e mosmirembjates. - Pikat kufitare te papajisura per transportin e mallrave; - Mungesa e procedurave dhe planeve	- Mundesia per te permiresuar infrastrukturen e transportit(psh. Linjat turistike ndershtetore sezonale mes Ohrit dhe Pogradecit), pikat e kalimit kufitar, si dhe sherbimet dhe logjistika shoqeruese, e cila do te lehtesoje bashkepunimin dhe komunikimin mes popullsise ne te dyja anet e kufirit; - Mundesia per zhvillimin e infrastrukturave qe lidhet me turizmin si qendra te reja skish lehtesira sportive, shtigjet per eskursione dhe ciklizem, teleferike etj.;	- Mungesa e planeve urbane dhe e pronesise shtetore mbi token mund te coje ne vonesen e zbatimit te projekteve infrastrukturore ne kete rajon; - Mungesa e mjeteve financiare lokale per mirembajtjen dhe riparimin e infrastrukturave se perkeqesuar lokale; - Mungesa e vemendjes dhe e mbeshtetjes per zhvillimin e programeve ekonomike dhe te bashkepunimit midis njerezve per shkak te mbitheksimit te rendesise se

kalimi kufitar.	urbanistike dhe prezenca e kaosit urban.	- Mundesia per zhvillimin e burimeve alternative te energjise; - Mundesia per zhvillimin dhe permiresimin e infrastruktures per perdorimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve ekzistuese ujore.	projekteve infrastrukture; - Rritja e marxhinalitetit si pasoje e investimeve te pamjaftueshme ne infrastruktura te komunikimit te permasave te vogla.
-----------------	--	--	--

PIKAT E FORTA	DOBESITE	MUNDESITE	RREZIQE
III. EKONOMIA			
- Lindja e sektorit privat te vogel e te mesem dhe shpirti i sipermarrjes; - Shumellojshmeria e aktiviteve ekonomike qe perfshijne turizmin, bujqesine/agrobiznes, industri dhe sherbime; - Potenciali i larte per zhvillimin e aktiviteve ekonomike miqesore ndaj mjedisit si turizem, bujqesia organike, teknologjite alternative te prodhimit te energjise; - Hapesirat dhe lehtesirat e disponueshme industriale, si dhe traditat industriale dhe zejtare.	- Perdorim joefikas i infrastruktures ndustriale ne dispozicion; - Konkureshmeria e kufizuar e sherbimeve dhe produkteve, per shkak te aksesit te limituar informacionin e tregut (rajonal dhe nderkombetar) , kapitaleve dhe teknologjive te reja; - Zhvillimi i ngadalte ekonomik dhe mjedisi i pafavorshem per biznesin per shkak te vazhdueshmerise se ekonomise informale dhe procedurave te nderlikuara administrative.; - Mungesa e organizimit te sektorit ekonomik (shume pak shoqaa te perfshira ne nje numer te vogel sipermarrjesh) - Permasat e vogla dhe produktiviteti i ulet i aktiviteve te agrobiznesit; - Numri i madh i sipermarrjeve te vogla eshte shume i brishte dhe i ndjeshem ne ndryshimet e politikave, fiskalitetit dhe tregut.	- Mundesia per te terhequr investimet e huaja te drejteperdrejta ne industrite dhe teknologjite miqesore ndaj ambientit; - Mundesia per te permirsuar cilesine dhe konkureshmerine e sherbimeve dhe produkteve nga sektori privat duke mbeshtetur futjen e standarteve nderkombetare te njohura dhe markimin e produkteve (perfshire zejtarine me dorës dhe produkteve agroushqimor); - Mundesia per nje zhvillim rajonal te ekuilibruar te bazuar ne vleresimin e aseteve specifike te cdo rajoni dhe bashkie (p.sh. turizmi dimeror e veror); - Mundesia per te zhvilluar grumbullime industriale dhe nderkufitare te bazuara ne perdorimin e qendrueshem te burimeve rajonale dhe natyrore ne fushat e agrobiznesit, pylletari, sherbime etj.; - Permirsimi i identitetit/imazh te rajonit do te rrise hyrjen e investimeve te huaja direkte.	- Mjedis i pafavorshem makro-ekonomik (akses i dobet ne linjat e kreditimit, mungese subvencionesh, dhe perjashtim nga taksat e biznesit), ekonomi dhe politika bujqesore jobashkekohore, mungese investimesh dhe ekonomi informale e persistuar. - Mungese e kuptimit te trendeve globale te tregut dhe proces i avashte e rrgullimit te ekonoise lokale. - Teknologjite industriale te rena mund te ulin konkurrueshmerine dhe potencialet krijuese dhe te rrezikojne burimet mjedisore, te konsideruara si vlere per rajonin.
IV. PUNESIMI, ARSIMI DHE BURIMET NJEREZORE			

- Prezenca e universiteteve kombetare dhe private dhe institucioneve arsimore per te siguruar fleksibilitet ne prodhimin e forces se kualifikuar te punes ne përputhje me trendin e tregut dhe nevojat. - Force pune e trajnuar ne drejtim te tradites bujqesore dhe industriale. - Kosto e ulet e krahut te punes	- Norme e larte papunësie, duke perfshire grate dhe burrat, qe con ne rritje te migrimit dhe perkeqesimit te standardeve te jetes ne zonat përfituese. - Migrim i brendshem ne qendrat urbane dhe moshë e popullsesise ojne ne depopullim ne zonat rurale ne disa nenrajone. - Mungesa e forces se kualifikuar dhe nevojës ne disa industri te veçanta si rezultat i trajnimit te burimeve njerezore; - Qendra dhe programe te pamjaftueshme te trajnimit profesional - Nivel i ulet i edukimit te popullsesise rurale dhe grupeve ne nevojë si Komuniteti Rom - Te ardhura dhe standarde jete te ulta mes pjeses me te madhe te forces aktive te popullsesise si pasoje e pagave te ulta ne sektorin publik dhe privat ; - Perjashtimi social i segmenteve te tera te popullsesise (te papunet afatgjate, romet etj community, etc.)	- Popullsia multietnike eshte nje vlere dhe siguron nje baze solide per zhvillimin ekonomik, socila, dhe kulturor; - Mundesi per arsimimin formal me aftesi te veçanta te kërkuara nga sektoret e shërbimeve dhe industrise.; - Mundesi per te permiresuar menaxhimin e biznesit dhe sipërmarrjeve; - Force pune ne dispozicion qe adoptohet lehte; - Mundesi per te zhvilluar dhe zbatuar programe te ri-kualifikimit dhe trajnimit; - Mundesi per zhvillimin e programeve per integrimin social te grupeve ne nevojë	- Fenomeni i migrimit te trurit - Procesi ne vazhdim i migrimit mund te coje ne depopullimin total te disa zonave rurale ne rajonin ndërkuftar.; - Akses i limituar i popullsesise rurale ne sistemin arsimor baze, si pasoje e varferise dhe kufizimit nga infrastruktura e keqe; - Rritja e kriminalitetit te te rinjve si rezultat i trendeve negative social-ekonomike - Prezenca sinjifikative e forces se paregjistruar dhe përjashtimit social te te papuneve afat-gjate.; - Rritja e normes se papunesise ne zonat përfituese qe vecanerisht prekin grupet me edukim te paket - Pagat e uleta dhe mundesite e kufizuara te punësimit mund te cojne ne rritjen e migrimit te krahut te punes dhe motivimin e tyre te paket per tu specializuar
--	---	---	---

PIKAT E FORTA	DOBESITE	MUNDESITE	RREZIQE
V. MJEDISI			
- Rajon i pasur me burime natyrore te pastra (ujera, lugina, pyje) qe mund te nxisin zhvillimin ekonomik; - Klime dhe kushte te favorshme klimaterike dhe gjeo-morfologjike dhe pasuri te tokave bujqesore ne pjesen e kufirit. - Aktivitete te vazhdueshme per ruajtjen e Ligeneve te Prespes dhe	- Mungese e kolektorëve te mbetjeve te ngurta dhe praktikave te riciklimit; - Boshlleqe lokale ambientale: psh, ne menaxhimin e mbetjeve, kanalizimeve, trajtimit te ujerave te zeza, demtimi i burimeve mjedisore.; - Ndotja e zonave ne territorin përfitues. - Nivel i ulet i zbatimit te	- Mundësi për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve miqësore ndaj mjedisit dhe teknologjitë më të mira të cilat optimizojnë shfrytëzimin e burimeve natyrore të pastra e të pandotura; - Mundësi për hartimin dhe zbatimin e projekteve ndërkufitare të ndryshme, bazuar në burimet natyrore dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit,	- Zhvillimi i ngadaltë infrastrukturës për mbrojtjen e mjedisit mund të ulë vlerat turistike të rajonit dhe ka impakt negativ në mirëqenien e popullatës vendore; - Zbatimi i ngadaltë i strategjive kombëtare dhe rajonale, normave ligjore dhe institucioneve për mbrojtjen e mjedisit;

Ohrit dhe rritjen e ndergjegjesimit te institucioneve lokale per ceshtjet ambientale.; - Shumellojshmeria e trashegimise natyrore, speciet e rralla, zona natyrore te vecanta dhe trashëgimi boterore si liqenet e Prespes dhe Ohrit, parqet kombetare, zona te mbrojtura natyrore si Parku Prespes, qe jane i pari rajon ndërkufitar i mbrojtur ne rajonin e Ballkanit.	legjislaconit komunitar per mjedisin ne sektoret publike dhe private;; - Potenciale natyrore nuk jane shfrytezuar ne menyre te qëndrueshme; - Nivel i pamjaftueshem i ndergegjesimit mbi problemet ambientale.	si dhe programe te menaxhimit ndërkufitar të burimeve natyrore; - Mundësi për përfshirjen e sektorit privat dhe shoqërisë civile në aktivitete dhe programe për mbrojtjen e mjedisit; - Mundësi për rritjen e ndërgjegjesimit publik për masat e mbrojtjes së mjedisit nën trysinë e kërkesave eko-turistike.	- Rreziku i zhdukjes së specieve autoktone dhe humbjeve në biodiversitet.
VI. KULTURE & TURIZEM			
- Trashëgimi historike e pasur dhe e diversifikuar që mund të përdoret për ta bërë ofertën turistike më tërheqëse; - Përvoja dhe kapacitetet ekzistuese (natyrore, infrastrukture, burimet njerëzore) në zhvillimin dhe forcimin e identitetit të rajonit, janë një aset për llojet konvencionale dhe alternative të turizmit; - Tradita e gjatë e evenimenteve kulturore të njohura nga bota, si dhe ekzistenca e evenimenteve kulturore ndërkufitare.	- Mungesa e analizave dhe strategjive të përbashkëta për përmirësimin e ofertës turistike, janë tregues të planifikimit dhe trajnimeve të pamjaftueshme mbi turizmin; - Promovimi dhe mbrojtja e pamjaftueshme e trashëgimisë kulturore dhe historike; - Zhvillimi i pabarabartë i infrastrukturës turistike ndërmjet rajoneve dhe ndërmjet shteteve; - Kapacitete të pamjaftueshme të burimeve njerëzore në sektorët e turizmit dhe kulturës.	- Mundësi për hartimin e strategjive të zhvillimit dhe programeve për zhvillimin e turizmit, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë historike dhe kulturore; - Mundësi për zhvillimin e tipeve të specializuara të turizmit (turizëm malor, vizita në qytete, llixhat, agro-turizmin, turizmin shëndetësor, turizmin çiklistik, etj.); - Mundësi për përfshirjen e sektorit privat në zhvillimin e kapaciteteve të rajonit në fushën e eko-turizmit; - Mundësi për zhvillimin e kapaciteteve institucionale vendore që lidhen me çështjet kulturore dhe tradicionale.	- Kultura dhe tradita mund të humbë autenticitetin dhe sensin atraktiv nëse industria e turizmit i shfrytëzon me tepri; - Mirëmbajtja konstante dhe mbrojtja e trashëgimisë historike dhe kulturore varet nga buxheti qendror; - Fondet e pamjaftueshme publike, si qendrore ashtu edhe vendore, për të mbështetur aktivitetet që promovojnë trashëgiminë kulturore dhe historike.

SEKSION II STRATEGJIA E PROGRAMIT

1. Eksperienca me aktivitetet nderkufitare dhe mesimet e nxjerra

Deri tani, iniciativat nderkufitare ne zonat perfituese kane pasur si qellim fushen e mjedisit dhe jane fokusuar kryesisht ne pjesen jugore. Megjithese rajoni tashme ka nje drejtim ne krijimin e menaxhimit te perbashket te burimeve natyrore transkufitare, bashkepunimi nderkufitar ne teresi eshte ende ne nivel te ulet. Pra, iniciativat ekzistuese ia vlen te permenden.

Dinamika e bashkepunimit nderkufitar mes ish Republikes Jugosllave te Maqedonise dhe Shqiperise ka filluar ne 1997-1999 nga Programi PHARE shume vendesh CREDO, qe kishte si qellim promovimin e marredhenjeve te mira te fqinjesise, stabilitetin social dhe zhvillimin ekonomik ne rajonin kufitar. Programi siguronte fonde per zbatimin e projekteve nderkufitare ne fushen e mjedist, bashkepunimit mes NGO-ve dhe administratave lokale. Projektet mendohej te krijonin kushtet e nevojshme per nje bashkepunim me thelbësor dhe projekte te perbashketa per zhvillim nderkufitar ne te ardhmen.

Megjithese Eurorajoni Prespa-Ohrid (Ish Republika Jugosllave e Maqedonise, Shqiperi dhe Greqia) nuk ishte krijuar ligjerisht ne vendet pjesmarrese, ky ishte nje hap perpara per zhvillimin e integruar rajonal ne pjesen jugore te zones nderkufitare. Fondacioni Maqedonas i Eurorajonit ekziston qe ne 2006 dhe pala shqiptare ka nje bord Eurorajoni, qe perfshin kryetaret e bashkive, kryetarin e Keshillit te Qarkut dhe Agjencine e Zhvillimit Rajonale te Korces. Mbeshtetur nga Keshilli Europian, Instituti EastWest dhe disa partnere te tjere krijimi i Eurorajonit padyshim po inkurajon lidhjet e partneritetit mes dy vendeve. Gjithashtu, duhet te permendet fakti qe ne kuadrin e projektit Eurorajon, institucioni East-West ka lancuar tashme dy thirrje te vogla per projekte per bashkepunimin nderkufitar (ne 2004 dhe 2006), duke marre pjese keshtu ne ndertimin e kapaciteteve te perfituesve te projekteve.

Projekti per Mbrojtjen e Liqenit te Ohrit eshte konsideruar shpesh si nje model i menaxhimit te integruar te burimeve ujore transkufitare. Ne 2004 qeverite e te dy vendeve nenshkruan nje marrëveshje "Per mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrueshem te Liqenit te Ohrit dhe rrjedhjet e tij". Strukturat e perbashketa ekzistuese, si dhe marrëveshjet bilaterale, sigurojne nje kuadër te mire per iniciativat e ardhshme nderkufitare.

Mbeshtetur nga UNDP dhe ende ne fazen fillestare, Projekti I Parkut Transkufitar te Prespes, perfshin ish REpublikën Jugosllave te Maqedonise, Shqiperine, dhe Greqine. Kjo eshte nje iniciative tjeter pioniere nderkufitare ne fushen e menaxhimit te burimeve natyrore.

Qendra Rajonale Mjedisore (REC) mbeshtet iniciativat nderkufitare mes Debar ne ish Republikën Jugosllave te Maqedonise dhe Peshkopise ne Shqiperi. Projekti trajnon vendim beresit lokale dhe ekspertet perkates per identifikimin dhe pregatitjen e projekteve te investimeve mjedisore dhe per krijimin e aplikimeve profesionale financiare. Problemet prioritare lidhur me furnizimin me uje dhe mbledhjen e derdhjen e ujerave te ndotur.

Organizata Nderkishtare per Zhvillimin e Bashkepunimit (ICCO) mbeshtet bashkepunimin nderkufitar dhe krijimin e rrjetit te shoqerise civile ne pjesen veriore te rajonit nderkufitar. Ky program ka si synim permiresimin e bashkepunimit nderkufitare duke nxitur bashkepunimin mes institucioneve lokale dhe organizatave te shoqerise civile, dhe rritjes se kapaciteteve organizative te organizatave respektive te shoqerise civile.

Nje iniciative e OSCE perpiqet per lehtësimin e partnershipeve dhe identifikimin e projekteve nderkufitare ne pjesen veriore te rajonit nderkufitar.

Mesimet e nxjerra

Pjesa me e madhe e iniciativave nderkufitare kane filluar vetem kohet e fundit ne menyre qe te percaktojne "mesimet e nxjerra" te cilat jane relevante per kuadrin e Komponentit te Dyte te IPA. Megjithate, pikat e meposhteme duhet te nënvizohen:

- Pjesa me e madhe e projekteve jane ne fushen e mbrojtjes se mjedisit. Keto projekte reflektojne prioritetet e percaktuara nga institucionet kombetare dhe lokale ndryshe nga shqetësimi i shoqerise civile dhe sektori privat. Sidoqofte, ato perbejne nje kuadër te mire per zhvillimin e shoqerise civile dhe partneritetit te NGOve ne kufi.

- Thirrjet e vogla per projekt propozime per aktivitetet nderkufitare tashme te lancuara treguan nje kapacitet te dobet ne pregatitjen e projekteve ne pjesen me te madhe te perfitueseve. Kjo gje mund te demtoje zbatimin e programit, vecanerisht ne pjesen veriore ku gati asnjë initiative nuk eshte zabtuar deri tani (me perjashtim te aksit Debar-Peshkopia).

- Pak bashki, me teper ne jug, kane pasur nje rol drejtues ne iniciativat e sotme dhe te kaluara nderkufitare. Keto bashki duhet te kene nje rol kyc ne zbatimin e ketij programi (transferimi i njohurive, etc.)

- Krijimi i partneriteteve nderkufitare do te jete nje problem i madh per pjesen me te madhe te perfituesve final. Nje mbështetje e veçante do te kërkohej me siguri per lehtësimin e komunikimit dhe vendosjen e partneriteteve.

2. Strategjia e bashkepunimit

2.1 Konkluzione te pergjithshme nga analizat

Ky seksion paraqet pergjigjen ndaj pengesave dhe dobësive te identifikuar gjate analizes. Ajo percakton strategjite e pershtatshme per nje zhvillim te perbashket te rajonit nderkufitar dhe perdorimi relevant i financimit te IPA-s. Strategji permban nje qellim te pergjithshem strategjik te programit dhe identifikon objektivat specifike qe duhet te arrihen me masat ne akset e perzgjedhura prioritare te programit.

Kur u percaktuan objektivat dhe prioritetet, komiteti i perbashket i programimit morri ne konsiderate:

- Heterogjenitetin e rajonit nderkufitar ne termat e pikëpamjes demografike dhe trendit ekonomik e nivelin e zhvillimit: prioritetet dhe masat duhet ti pergjigjen situatave te ndryshme e disa here kontradiktore.

- Sasise se vogel relativisht te fondeve ne dispozicion te programit: masat nuk vene theksin mbi investimet ne infrastrukturen e rende ne komunikim dhe transport, megjithëse eshte shpesh e konsideruar si prioritet nga institucionet.

- Niveli i ulet i bashkëpunimit nderkufitar, vecanerisht mes NGO-ve dhe shoqerise civile, programi duhet ti jape rendesi krijimit te nje bashkëpunimi afatgjate ne nivel komuniteti.

- Nevoja per te kombinuar mbrojtjen e burimeve unike dhe te brisht natyrore dhe trashegimise kulturore me zhvillimin masiv te turizmit ne pjesen jugore te rajonit nderkufitar.

- Prezenca e universiteteve dhe instituteve kerkimore ne te dy anet e rajonit nderkufitar eshte konsideruar si aset per dinamizmin dhe reputacionin e rajonit.

2.2 Objektivat e programit te bashkepunimit nderkufitar

Qellimi kryesor i programit eshte te

Nxise zhvillimin e qendrueshem ne zonen nderkufitare

Aktivitetet e perbashketa dhe projektet e natyres nderkufitare qe do te zbatohen pritet te kene nje impakt ne gjendjen sociale dhe ekonomike te popullsisë, permiresimit te menaxhimit dhe ruajtjes se perbashket te burimeve natyrale dhe kulturore dhe forcimin e imazhit dhe kohezionit te rajoneve dhe nenrajoneve.

Programi ka tre objektiva specifike:

- Objektivi 1: te mbeshtese ndermarrjen e aktiviteteve dhe hartimin e strategjive te perbashketa qe synojne ruajtjen dhe rritjen e vlerave te burimeve natyrore ne rajon. Programi synon mbeshtetjen dhe fuqizimin e experiences se krijuar dhe tendences ekzistuese per lidhjen e problemeve te ambientit me masa te ndryshme ne te dyja anet e kufirit. Perfituesit e percaktuar jane autoritete lokale, institucionet e decentralizuara si dhe organizatata e shoqerise civile.


- Objektivi 2: te nxise zhvillimin ekonomik te rajonit. Turizmi do te jete aktiviteti ekonomik paresor i programit. Ai perben nje mundesi te vertete per zhvillimin e rajonit dhe burimin kryesor te rritjes se te ardhurave dhe punesimit ne te dyja anet e kufirit, duke kontribuar ne menyre te barabarte ne zhvillimin e te dy vendeve. Duke pasur parasysh problemin nje eko-sistemi te ndjeshem, turizmi perben dhe nje kercenim nga ana tjeter per rajonin, qe duhet te merret ne konsiderate. Ndersa sektori privat ndikon ne zhvillimin e infrastruktures se turizmit, te orientuar kryesisht drejt turizmit masiv, programi do te fokusohet ne zhvillimin e llojeve te ndryshme turizmit alternativ dhe infrastruktures te vogel, ne transferimin e eksperiences nga nje rajon dhe vend ne tjetrin dhe ne aktivitete trajnimi ne mbrojtjen e pasurimin e trashegimise kulturore dhe historike. Me ne pergjithesi programi do te nxise

zhvillimin e qendrueshem te te gjitha tipeve te aktiviteteve, shërbimeve dhe prodhimit, pjesemarrëse ne ndertimin e nje identiteti dinamik dhe atraktiv rajonal. Kjo perfshin organizatat, mbrojtjen (parketimin) dhe lidhjen me tregun (kanalet e furnizimit ushqimor) te produkteve tradicionale agro-ushqimore dhe punimeve me dore, përcaktimin e kërkimeve te perbashketa dhe programet e zhvillimit.

- Objektivi 3: eshte nje objektivi i nderthurur: te zhvilloje partneritetin dhe bashkepunimin afatgjate ndermjet organizatave te shoqerise civile (NGOs, organizatave kulturore e sportive, etj), organizatave profesioniste (d.m.th Dho,ave te Tregetise, organizatave te sipermarrësve dhe fermereve) institucioneve te dekoncentruara, ne menyre te vecante shkollave dhe fakulteteve, perfshire dhe organet kerkimore e shkencore. Duke marre ne konsiderate intensitetin e bashkepunimit nderkufitar, inkurajimin dhe vendosjen e partneriteteve afatgjata, komunikimin pertej-kufijve eshte nje nga problemet kryesore gjate gjithë periudhes se zbatimit te programit. Ky objektivi do te arrihet ndermjet zbatimit te skemave te granteve per aktivitete te tipit people-to-people. Projektet qe kane nje dimension kulturor dhe social, si dhe projektet te tipit ekonomik/tregetar (organizimi i panairove, studimeve te tregut, etj.) do te kene perparësi me te madhe.

3. Prioritetet dhe masat

Objektivat e mesiperme do te arrihet nepermjet zbatimit te prioritetit te pare te mbështetur nga tre masa dhe prioritetit te dyte per asistencen teknike per programin.



3.1 Prioriteti I

Nxitja e zhvillimit ekonomik, ambjental dhe social

Ky është një prioritet në përgjigje të situatave të ndryshme dhe nevojave të identifikuara brenda rajonit nderkufitar. Mbrojtja dhe menaxhimi i burimeve njerezore konsiderohen si problemet kryesore në pjesën jugore (liqenet e Ohrit dhe të Prespes), ndërsa problemet e varferisë dhe papunësisë si problemet më të mëprehta për pjesën veriore. Prioriteti i parë tenton t'u përgjigjet këtyre dy problemeve. Ai gjithashtu synon të krijojë hapsirat e duhura aktoreve ekonomike, në mënyrë të vecantë, por jo ekskluzivisht, sektorit të turizmit, i cili mban parasysh nivelin e ulet të bashkëpunimit tregëtar ndërmjet të dy anëve të kufirit. Me gjerësisht, ky prioritet do të ndihmojë në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme ndërmjet komuniteteve në këtë zonë duke nxitur me tej bashkëpunimin ndërmjet tyre si dhe organizatave të shoqërisë civile.

Ky prioritet përmban tre masa specifike:

Nr.	Masa
Masa I.1	Zhvillimi ekonomik me një theks në zonat turistike
Masa I.2	Zhvillimi i panderprere mjedisor me theksin në mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin i burimeve natyrore dhe ekosistemit
Masa I.3	Kohezioni social dhe ndryshimet kulturore nepermjet bashkëpunimeve ndërmjet komuniteteve (people to people) dhe ndërmjet institucioneve

3.1.1 Masa I.1

Economic development with an emphasis on tourism related areas

Zhvillimi ekonomik me një theks në zonat turistike

Objektivi specifik i kësaj mase është::

Promovimi i zhvillimit ekonomik në zonën e programit nepermjet vlerësimit ekonomik të potencialit të tij turistik dhe kulturor

Turizmi është potenciali kryesor në rajon dhe në disa zona është zhvilluar, pothuajse si industri. Kjo masë synon të mbështet zhvillimin e infrastruktures të përmirësuar relativisht të vogla, praktikave të dobishme dhe planeve strategjike për të shtrirë aktivitetet turistike në të gjithë rajonin nder kufitar. Vëmendje e vecantë i është dhënë përcjelljes së njohurive teknike nga Republika e Maqedonisë për Shqipërinë ku industria e turizmit është akoma etapë e parë. Masa i jep prioritet llojeve të ndryshme të turizmit të sotëm (turizmit rural dhe familjar, eko-turizmit, etj) për të zhvilluar ato paralel me praktikën klasike. Përgjithësisht, masa e ve theksin në përkujdesjen e të gjithë sektoreve të ekonomisë që kontribuojnë në ndërtimin e identitetit të vecantë dhe të fortë të rajonit nder-kufitar. Kjo përfshin promovimin dhe mbrojtjen (markat, aksesin me të mirë në treg) të ushqimeve tradicionale dhe të produkteve ushqimore bujqësore, si dhe të artizanatit. Si një objektivi i terthorë dhe për t'i dhënë komunitetit të biznesit mundësinë për marrë pjesë në programet nderkufitare, masa gjithashtu synon në lehtësimin e bashkëpunimit tregëtar nder-kufitar (d.m.th organizimin e panairëve, studimet për konsumatorët, studimet për tregun etj)

Aktivitetet e mundshme në këtë masë përfshijnë:

Aktivitete	Indikatore ¹⁹
Zhvillimi dhe implementimi i strategjive, planeve të veprimt, studimeve dhe analizave të përbashkëta të tregut	Numri i dokumentave të bërë të zbatuar (strategji, plane veprimt, studime dhe analiza krahasimore) (9)
Lehtësime për kontaktim tregëtar, nderlidhjen, partneritetin	Numri i bizneseve të kontaktuar dhe partnershipeve të krijuara (8)
Zhvillimi dhe implementimi i studimeve, analizave dhe masave për përmirësimin e ofertes turistike tradicionale dhe alternative nderkufitare	Numri i studimeve të zhvilluara dhe zbatuara, analizave dhe masave (14)

¹⁹ Vlerësimi i indikatoreve për të gjitha masat është bazuar në alokimet financiare 2007-2009.

Investime ne projekte te vogla te infrastruktures turistike dhe tregtare	Numri i investimeve lidhur me infrastrukturen turistike (7)
Promovimi i produkteve rajonale, sherbimeve dhe organizatave te rrjeteve te furnizimit ushqimor	Numri i iniciativave te promocionit dhe parketimit te mbështetura (14)
Zhvillimi dhe implementimi i aktiviteteve trajnuese, edukuese dhe transferimi i njohurive ne fushen e turizmit dhe marketingut te biznesit, sistemeve cilesore ICT, Parakualifikimet e punes, etc.	Numri i programeve te trajnimit dhe arsimimit te zbatuara (14) Numri i pjesmarresve ne programet e edukimit dhe trajnimit (280)

Perfituesit qe do te perfshihen (kjo liste nuk eshte ekskluzive):

- Autoritetet rajonale dhe lokale;
- Njesite administrative dhe juridike ne nivelin lokal;
- Agjensite rajonale dhe kombetare (pergjegjese ne nivel qendror, rajonal, bashkiak), administratat e parqeve natyrore, drejtorite pyjore lokale/rajonale, institucionet e shendetit publik, etj;
- Organizata, shoqata dhe fondacione jo-qeveritare ose jo-perfituese (OJQ-OJF), agjensi zhvillimi, agjensite qe merren me IT, agjensi zhvillimi, edukimi, trajnimi dhe institucione, shoqerite prodhuese;
- Dhomat e tregtise;
- Agjensite dhe organizatat shtetore dhe publike;
- Ndermarrjet publike;
- Ndermarrjet e vogla dhe te mesme;

3.1.2 Masa I.2

Zhvillimi i panderprere mjedisor me theksin ne mbrojtjen, promovimin dhe manaxhimin i burimeve natyrore dhe ekosistemit

Objektivi specifik i kësaj mase eshte:

- Mbështetja e iniciativave te perbashketa dhe aktiviteteve me qellim mbrojtjen, promovimin dhe manxhimin e ekosistemeve dhe zhvillimin e qendrueshem mjedisor ne zone.

Kjo mase ka qellim te ngreje dinamikën nderkufitare te shpallur ne sektorin mjedisor gjate viteve te fundit. Mbeshtet perpjekjet e tanishme te autoriteteve kombetare dhe lokale ne vendosjen e politikave te perbashketa mjedisore dhe programeve pilote qe perfshijne shoqerine civile ne kete proces. Ajo merr parasysh edhe rendesine kritike te manaxhimit te vazhdueshem te burimeve natyrore per zhvillimin ekonomik te rajonit.

Aktivitetet e mundshme ne kete mase perfshijne:

Aktivite	Indikatore
Zhvillimi dhe implementimi i strategjive, politikave, planeve te perbashketa te veprimit ose studimeve te fizibilitetit ne lidhje me ceshtjet e mjedisit duke perfshire ujerat e ndotura manaxhimi i mbetjetje solide, manaxhimi i ujerave, manaxhimi i pyjeve, rregullimin e shtreterve te lumenjve, biodiversiteti, mbrojtjen e tokes, kontrolli i ndotjes se ajrit, gjithashtu plane te emergjences nderkufitare qe te perballen me rreziqet mjedisore natyrore dhe nga dora e njeriut, etj.	Numri i dokumentave te bere (strategji, politika, plane veprimi per studime fizibiliteti (13)
Investime ne zhvillimin e projekteve te vogla te infrastruktures nderkufitare (small-scale) ne fushat e mjedisit dhe gatishmerine per emergjencat civile, pastrimi i zonave te hedhjes se mbeturinave te pakontrolluara, gjithashtu aktivitete te perbashketa me qellim te identifikimin, ruajtjen, zhvilimin dhe mirembajtjen and restaurimin e parqeve kombetare dhe te zonave te mbrojtura, flora, fauna, etj.	Numri i investimeve te bera ne infrastrukturen e vogel nderkufitare (8)
Zhvillimi i dhe implementimi i programeve trajnuese dhe edukuese ne lidhje me aktivitet e mbrojtjes mjedisore	Numri i programeve arsimore dhe trajnuese te zbatuara (10)

	Numri i pjesmarresve ne programet e trajnimit dhe arsimit (200)
Krijimi dhe implementimi i fushatave per promovimin, ndergjegjesim te plote, dhe fushata informative ne lidhje me ceshtjen e mjedisit	Numri i fushatave promocionale dhe informative te mbështetura (10)

Perfituesit qe do te perfshihen (kjo liste nuk eshte ekskluzive):

- Autoritetet rajonale dhe lokale;
- Njesite administrative dhe juridike ne nivelin lokal;
- Agjensite rajonale dhe kombetare (pergjegjese ne nivel qendror, rajonal, bashkiak), administratat e parqeve natyrore, drejtorite pyjore lokale/rajonale, institucionet e shendetit publik, etj;
- Organizata, shoqata dhe fondacione jo-qeveritare ose jo-perfituese (OJQ-OJF), agjensi zhvillimi, agjensite qe merren me IT, agjensi zhvillimi, edukimi, trajnimi dhe institucione, shoqerite prodhuese;
- Dhomat e tregtise;
- Agjensite dhe organizatat shteterore dhe publike;
- Ndermarrjet publike;
- Ndermarrjet e vogla dhe te mesme;

3.1.3 Masa I.3

Kohezioni social dhe ndryshimet kulturore nepermjet bashkepunimeve ndermjet komuniteteve (people to people) dhe ndermjet institucioneve

Objektivi specifik i kësaj mase eshte:

- Te promovojë aktivitetet mes komuniteteve dhe institucioneve (si shkollave, universiteteve, qendrave kerkimore)

Bazuar ne faktin qe bashkepunimi nderkufitar eshte akoma ne nivel te ulet, masa e trete ka qellim te promovojë operimet njeri-njeri dhe institucion-institution (si shkollat, universitetet, qendrat kerkimore). Sektorët prioritarë janë vlerësimi i historisë unike dhe trashgimisë kulturore dhe të gjitha llojet e operimeve që mbështesin integritetin social të grupeve të vunerabel dhe të lena menjane, të te papuneve, rinisë rurale, forcen punetore të gruas, etj. Kjo mase gjithashtu synon ne inkurajimin e kerkimeve te perbashketa dhe aktiviteve edukuese.

Aktivitetet e mundshme ne kete mase perfshijne:

Aktivitetet	Indikatoret
Zhvillimi dhe implementimi I programeve per integrimin social te socially marginalized groups, te te papuneve, rinise rurale, forcen punetore te gruas, etj;	Numri i programeve te bera dhe zhvilluara (9)
Mbeshtetje te programeve te perbashketa te bazuara ne shfrytezimin e aseteve multietnike	Numri i programeve te perbashketa te mbështetura (4)
Mbeshtetje te iniciativave te zhvillimore kerkimore te insitucioneve te zhvillimore kerkimore	Numri i iniciativave kerkimore zhvillimore te mbështetura (4)
Krijimi i partneriteteve mes NGO-ve ne te dy anet e kufirit dhe aktiviteve per zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe manaxhuese te NGO-ve	Numri i iniciativave te partneritetit mes NGO-ve te mbështetura (5)
Mbeshtetje te aktiviteve lidhur me kujdesin shendetesor te mbeshtetura	Numri i programeve te perbashketa per mbrojtjen e shëndetit te mbështetura (9)
Mbeshtetjeve te ngjarjeve dhe aktiviteve kulturore te perbashketa dhe projekteve te perbashketa qe synojne promovimin dhe ruajtjen e trashgimise kulturore dhe historike	Numri i aktiviteve te perbashketa kulturore te mbeshtetura (14)

Perfituesit qe do te perfshihen (kjo liste nuk eshte ekskluzive):

- Autoritetet rajonale dhe lokale;
- Njesite administrative dhe juridike ne nivelin lokal;
- Agjensite rajonale dhe kombetare (pergjegjese ne nivel qendror, rajonal, bashkiak), administratat e parqeve natyrore, drejtorite pyjore lokale/rajonale, institucionet e shendetit publik, etj;
- Organizata, shoqata dhe fondacione jo-qeveritare ose jo-perfituese (OJQ-OJF), agjensi zhvillimi, agjensite qe merren me IT, agjensi zhvillimi, edukimi, trajnimi dhe institucione, shoqerite prodhuese;

- Dhomat e tregtise;
- Agjensite dhe organizatat shteterore dhe publike;
- Ndermarrjet publike;
- Ndermarrjet e vogla dhe te mesme;

Kriteri per vlerësimin e projekteve:

Ne pergjithesi, zonat përfituese brenda cdo mase duhet te permbushë kriterin ne vijim:

- Ka partnere nga te dy anet e kufirit
- Vendos kontakte dhe lidhje mes komuniteteve lokale ne zonen e programimit
- Mbeshtet lidhjet mes institucioneve perkatese dhe organizatave nga te dy anet e kufirit.
- Inkurajon pjesëmarrjen e barabarte te grave dhe grupeve ne nevoje
- Jane nga pikëpamja mjedisore te qëndrueshme

3.2 Prioritet II, asistenca teknike

Objektivi i asistences teknike eshte te permiresoje cilesine e bashkepunimit nderkufitar dhe mjeteve te manaxhimit.

Ky prioritet do te zbatohet nepermjet dy masave.

Nr.	Masa
Masa II.1	Zbatimi dhe administrimi i programit
Masa II.2	Informim, publicitet dhe vlerësim

3.2.1 Masa II.1

Zbatimi dhe administrimi i programit

Nje liste treguese e aktiviteve te lejuara nen kete mase mund te perfshije:

- Mbeshtetje per Strukturat Operuese, Komitetin e Perbashekt te Monitorimit, Sekretariatit te Perbashket Teknik dhe strukturave te tjera (psh: Komiteteve Drejtuese) te involvuara ne menaxhimin dhe zbatimin e programit.

- Ngritja dhe funksionimi i Sekretariateve te Perbashketa Teknike dhe antenave te tyre, duke perfshire kostot e rimbursimit te stafit (me përjashtim te pagave te punonjësve publike)

- Shpenzimet per pjesëmarrje ne takime te ndryshme lidhur me zbatimin e programit

- Kosto administrative dhe lokale lidhur me zbatimin e programit, duke perfshire koston e pregatitjes dhe monitorimit te programit, dorëzimit dhe vlerësimit te projekteve, organizimit te takimeve e te komitetit te monitorimit etj.

- Asistence per përfituesit finale ne pregatitjen e aplikimeve me projekte dhe te përfituesve ne zbatimin dhe raportimin e zbatimit te tyre.

INDIKATORE	
Indikatore per verifikimin e objektivit	
	Numri i stafit te SPT i rekrutuar
	Numri i takimeve te KPM te organizuara
	Numri i aktiviteve trajnuese per përfituesit final potencial
	Numri i përfituesve qe asistohen
	Numri i projekt propozimeve te vleresuara
	Numri i vizitave ne vend
	Numri i raporteve te monitorimit te hartuara

Indikatore rezultatesh	SPT dhe Pika Info te ngritura
	Publikimi i te rejave dhe aktiviteve
	Aktivite te asistences ndaj perfituesve per pregatitjen e projekteve
	Publikimi i studimeve dhe analizave
Indikatore impakti	Kapacitete te rritura ne stafin e OS
	Efektivitet i rritur i programit
	Ulje e % se kostove jo te lejueshme nga perfituesit financiar
	Rritja e cilesise se pergjithshme te projekt propozimeve
	Rritja e numrit te pergjithshem te numrit te projekteve te projekt perfituesve
	Eficense e rritur, efektivitet i nderhyrjeve
Indikatore financiare	Norma (%) e pagesave/ planifikimeve ndaj burimeve
	Norma (%) e pagesave angazhimeve ndaj burimeve
	Norma (%) e fondeve te perdorura ndaj atyre te alokuara

3.2.2 Masa II.2

Informim, publikime, dhe vleresime

Nje liste treguese e aktiviteve te lejuara mund te perfshije:

- Pregatitjen, perkthimin dhe shperndarjen e materialeve dhe publikimeve informative lidhur me programin, perfshire faqen e internetit te programit
- Organizimi i aktiviteve publike (konferenca, seminare, workshope, etj.)
- Ndergjegjesim dhe trajnim per perfituesit potenciale, duke perfshire forumet e kerkimit te partneritetit

- Vleresim programi

INDIKATORE	
Indikatore per verifikimin e objektivit	Numri i aktiviteve realizuar
	Website i bere
	Numri i informacioneve te shperndara
	Numri i gazetave te bera
	Numri i perdoruesve te website
Indikatore rezultatesh	Publikimi i lajmeve dhe aktiviteve
	Publikimi i praktikave me te mira
	Publikimi i studimeve dhe analizave
Indikatore impakti	Eficensa e sistemit te komunikimit
	Indergjegjesimi i rritur i publikut ne pergjithesi per programin dhe nderhyrjet e tij
	Transparence e rritur e veprimtarise se programit dhe rezultateve mes perfituesve
	Norma (%) e fondeve perdorur ndaj atyre alokuar

Perfituesit kryesore duhet te jene:

- Strukturat Operuese;
- Komiteti i Perbashket Monitorues;
- Sekretariati i Perbashket Teknik (Kryesori dhe antenat);
- Te gjitha strukturat lidhur me zhvillimin dhe zbatimin e Programeve Nderkufitare (psh. Komiteti Drejtues/Seleksionues)
- Perfituesit e programit

Komponenti i Asistences Teknike do te jete i vlefshem per maksimumin deri ne 10% te alokimit financiar total. Persa i perket zbatimit te Masave te Prioretetit Asistence Teknike (AT), do te nenshkruhet nje marreveshje granti direkte pa thirrje per projekt propozime ndermjet secilit Delegacion te Komisionit European dhe autoriteteve kombetare (Strukturave Operacionale ose koordinatorëve te bashkepunimit nderkufitar sic eshte e pershatshme) duke patur parasysh se keta te fundit gezojne de facto nje situatë monopoli (sipas Nenit 168, paragrafi 1, nenparagrafi c i Rregullave te Zbatimit te Rregullores Financiare). Zbatimi i Masave mund te kerkoje subkontraktimin nga autoritetet kombetare per sigurimin e sherbimeve ose furnizimeve.

Me qellim sigurimin e nje perdorimi eficient te fondeve te AT, eshte i nevojshem nje bashkepunim i ngushte ndermjet autoriteteve kombetare te vendeve pjesemarrese.

4. Koherenca me programe te tjera

Programi nderkufitar eshte hartuar ne perputhje me kuadrin e percaktuar nga Dokumenti i Planifikimi Indikativ Shumevjecar (Multi-annual Indicative Planning Document (MIPD) te secilit vend. Ai propozon masa qe nderthurren me njera-tjetren, te identifikuar si prioritete ne pothuajse te gjitha planet strategjike kombetare dhe lokale.

4.1 Programet e ish-Republikes Jugosllave te Maqedonise

Ne ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise, programet nderkufitare perputhen me dokumentat strategjike te meposhtem:

- Strategjia e programit nderkufitar eshte e lidhur me Planin Kombetar te Zhvillimit 2007-2009 (PKZH) dhe bazohet ne te njejtat supozime. Ai thekson sektoret te cilet perputhen me drejtimin nderkufitar dhe qe jane identifikuar tashme si prioritete ne PKZH: zhvillim dhe shumellojshmeria e industrise se turizmit, rritja e kerkimit dhe zhvillimi, rritja e kapaciteteve administrative, permiresimi i infrastruktures mjedisore, plani i zhvillimit rural duke perfshire zonat me pak te favorizuara etj.

- Programi Operacional per Ndertimin Institucional (Komponenti 1 i IPA-s) do te kontribuojë drejt ecjes perpara te infrastruktures lokale per zhvillim ekonomik dhe social, megjithese ne nje nivel me te larte sesa programi nderkufitar. Fokusi i mbeshtetjes do te jete kryesisht ne zhvillimin e infrastruktures ne bashki, si dhe trajnimi i nepunesve te bashkive, ne zhvillimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e ketyre projekteve te infrastruktures.

- Programi Operacional per Zhvillimin Rajonal (Komponenti 3 i IPA-s) e ve theksin ne ceshtje te ambientit, ne menyre te vecante ne nevojën per te mbeshtetur ngritjen e sistemeve te qendrueshme te menaxhimit te ujit dhe mbetjeve. Zhvillimi i nje korridorit te VIII Pan-European eshte permendur si prioritet ashtu sic eshte ne programin nderkufitar.

- Programi nderkufitar eshte ne nje linje me pjesen me te madhe te masave te percaktuara ne Programi Operacional per Burimet Njerzore (Komponenti 4 i IPA-s): zhvillimi i edukimit te te rriturve dhe mesimin gjate gjithë jetes, duke forcuar integrimin social te njerezve dhe zonave te pafavorshme, duke permiresuar premiset e tregut te punes per te rinjte dhe grate etj. Vec kesaj, komponenti per Zhvillimin e Burimeve Njerezore duhet te pergatise vendin per zbatim dhe menaxhim te fondeve nga Fondi Social European (FSE).

- Programi per Zhvillimin Rural 2007-2013 (Komponenti 5 i IPA-s) percakton si masa prioritare: permiresimin e efektivitetit te prodhimit bujqesor, duke e sjelle ate ne perputhje me kerkesat e tregut; sigurimin e nje industrie ushqimore konkurruese dhe eficiente; dhe duke siguruar kushtet per nje zhvillim rural te qendrueshem per te kontribuar ne zhvillimin socio-ekonomik te zonave rurale. Programi nderkufitar mund te kontribuojë per te arritur keto objektiva.

- Dy rajone (Jugperendimi dhe Pelagonia) perfituese nga programi nderkufitar me Shqiperine jane gjithashtu perfituese nga programi nderkufitar 2007-2013 ndermjet Greqise dhe Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise. Objektivi kryesor i ketij programi (Promovimi i nje zhvillim lokal te qendrueshem ndermjet nje bashkepunimi nderkufitar te nje cilesie te larte) dhe dy akset e tij prioritare ("Forcimi i zhvillimit ekonomik nderkufitar" dhe "Rritja e burimet mjedisore dhe trashigimmise kulturore te zones kufitare perfituese") jane plotesuese te objektivave dhe prioriteteve te percaktuara ne dokumentin e prezantuar .

4.2 Programet e Shqiperise

Ne Shqiperi, programi nderkufitar perputhet me dokumentat strategjike te meposhtme:

- Strategjia Kombetare per Zhvillim Ekonomik (SKZHE). Ajo thekson sektoret qe perputhen

me drejtimin nderkufitar dhe qe jane identifikuar si prioritete ne SKZHE: permiresimi i infrastruktures se ambjentit, zhvillimi urban dhe rural ne vecanti ne zonat me te varfera dhe me te largeta, zhvillimi dhe sumellojshmeria e industrise se turizmit, rritja e kerkimit dhe zhvillimit, rritja e kapaciteteve administrative, etj.

- Strategjia e Decentralizimit e cila krijon bazat per thellimin e rolit te njesive te pushtetit vendor ne lidhje me ceshtje te lidhura me programet e zhvillimit ekonomik dhe social, bashkepunimi nderkufitar dhe rajonal.

- Strategjia e Zhvillimit Rajonal- Objektivat e Zhvillimit te Mijevjecarit 2003 (OZHM), per Qarkun e Korces, dokumenti Promovimi i Zhvillimit Lokal nepermjet OZHM 2003 – Qarku i Elbasanit dhe Promovimi i Zhvillimit Lokal nepermjet OZHM 2003 – Qarku i Dibres. Te treja keto dokumente theksojne bashkepunimin nderkufitar si nje mjet per te mbeshtetur zhvillimin ekonomik dhe social te rajoneve. Ato e vene theksin ne ceshtjet e ambjentit, te cilat jane te lidhura shume me situaten shendetesore dhe me ceshtje te tjera sociale. Vec kesaj, forcimi i integritit social te njerezve dhe zonave ne disavantazh, dhe permiresimi i premisave te rinjve dhe grave ne tregun e punes, jane konsideruar pjese e objektiveve te rajonit per te arritur qellimet e OZHM-se.

4.3 Ceshtje horizontale

Mbrojtja e ambjentit: masa dy i eshte dedikuar krejtesisht kesaj ceshtje. Qellimi i aktiviteve te propozuara do te jete te rrise ndergjegjesimin ne ceshtjet e ambjentit dhe te inkurajoje sektoret private dhe bashkite e vogla per te marre pjese me aktivisht ne dinamiken e shpallur tashme ne nivel institucional.

Mbeshtetje per minoritetet dhe grupet ne nevoje: masa tre ka per qellim zhvillimin dhe zbatimin e programeve per integrim social te grupeve ne nevoje si te papunet, rinine rurale, dhe forcen e punes te perfaqesuar nga grate. Pjesa me e madhe e aksioneve kulturore do te zbatohen ne kuader te kesaj mase duke patur si qellim vleresimin e karakteristiken multi-etnike te rajonit, duke e konsideruar si aset per zhvillimin ekonomik dhe social. Per kete arsye pjesemarrja e minoriteteve dhe grupeve ne nevoje ne aktivitetet nderkufitare do te inkurajohet fuqimisht.

Perdorimi i qendrueshmerise si faktor qe te shyn drejt fitimit: masa qe theksojne zhvillimin lokal te qendrueshem, vecanerisht te sektorit te turizmit ne rajonin nderkufitar. Ky sektor eshte tashme i zhvilluar mire ne pjesen jugore te rajonin nderkufitar te Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise. Objektivi eshte qe te krijohen kushte te nje zhvillimi te ngjashem ne pjese te tjera te rajonit, (transferimi i know-how, permiresimi i kapaciteteve, infrastruktura te nje niveli te ulet, etj.).

PJESA III DISPOZITAT FINANCIARE

Alokimi financiar i programit nderkufitar per periudhen 2007-2009 eshte rene dakort nga te dy vendet dhe eshte si me poshte:

2007								
Priority	former Yugoslav Republic of Macedonia				Albania			
	Community funding	National funding	Total funding	Rate of Community contribution (d) = (a)/(c)	Community funding	National funding	Total funding	Rate of Community contribution (d) = (a)/(c)
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)		(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	
Priority Axis 1: Fostering cross-border economic, environmental and social development	1.980.000	350.000	2.330.000	85%	990.000	180.000	1.170.000	85%
Priority Axis 2: Technical Assistance	220.000	40.000	260.000	85%	110.000	20.000	130.000	85%
TOTAL	2.200.000	390.000	2.590.000	85%	1.100.000	200.000	1.300.000	85%

2008								
Priority	former Yugoslav Republic of Macedonia				Albania			
	Community funding	National funding	Total funding	Rate of Community contribution (d) = (a)/(c)	Community funding	National funding	Total funding	Rate of Community contribution (d) = (a)/(c)
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)		(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	
Priority Axis 1: Fostering cross-border economic, environmental and social development	900.000	159.000	1.059.000	85%	675.000	119.150	794.150	85%
Priority Axis 2: Technical Assistance	100.000	18.000	118.000	85%	75.000	13.250	88.250	85%
TOTAL	1.000.000	177.000	1.177.000	85%	750.000	132.400	882.400	85%

2009								
Priority	former Yugoslav Republic of Macedonia				Albania			
	Community funding	National funding	Total funding	Rate of Community contribution (d) = (a)/(c)	Community funding	National funding	Total funding	Rate of Community contribution (d) = (a)/(c)
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)		(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	
Priority Axis 1: Fostering cross-border economic, environmental and social development	900.000	159.000	1.059.000	85%	765.000	135.000	900.000	85%
Priority Axis 2: Technical Assistance	100.000	18.000	118.000	85%	85.000	15.000	100.000	85%
TOTAL	1.000.000	177.000	1.177.000	85%	850.000	150.000	1.000.000	85%

Shenime:

Ne ish-Republiken Jugosllave te Maqedonise, per shkak te pamundesise per te percaktuar nje strategji nderkufitare per vitin 2007 me Serbine dhe Kosoven nen UNSCR 1244, eshte vendosur qe fondet te cilat ishin planifikuar fillimisht per kete kufi ne vitin 2007, ti rialokohen kufirit me Shqiperine. Kjo shpjegon dhe mosperputhjen ndermjet alokimit per vitin 2007 dhe tre viteve te tjera.

PJESA IV RREGULLAT E ZBATIMIT

Rregullat e zbatimit per kete program nderkufitar jane bazuar ne Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 718/2007 (ne vijim referuar si “Rregullorja e Zbatimit IPA”), e cila zbaton Rregulloren e Keshillit (EC) Nr. 1085/2006, e cila harton nje instrument per asistencen e para-aderimit.

Ne perputhje me Nenin 10(2) Rregullorja e Zbatimit IPA, te dy vendet do te menaxhojne programin ne perputhje me modelin e menaxhimit te centralizuar²⁰ ku Delegacionet respektive te Komisionit European do te jene Autoritetet Kontraktuese.

Rregullat e zbatimit te programit jane bazuar ne principin e barazise per te dy vendet perfituese duke patur nje rol te njejte ne strukturat menaxhuese te bashkepunimit nderkufitar. Menaxhimi i perbashket i programit do te siguroje nje zoterim lokal, perfshirje te gjere, planifikim me te mire dhe do te krijojte bazen per aktivitete nderkufitare te sinqerta.

1. Strukturat e programit

1.1 Strukturat organizative ne nivel kombetar

Ne perputhje me Nenin 32(2) Rregullorja e Zbatimit IPA, ne cdo vend Koordinator Kombetar IPA ka emeruar nje Koordinator per Komponentin II te IPA-s:

Ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise, Zevendes kryeministri per Ceshtjet Europiane eshte emeruar si Koordinator Kombetar IPA, i cili vepron si perfaqesues i Ish Republikes Jugosllave te Maqedonise perballe Komisionit. Ne perputhje me Nenin 32(2) te Rregullores se Zbatimit IPA, Ministri i Veteqeverisje Lokale eshte percaktuar si Koordinator per Komponentin II te IPA-s.

Ne Shqiperi Koordinator Kombetar IPA eshte Ministri i Integritetit European (MIE). Brenda MIE, Drejtoria per Mbeshtetje Institucionale dhe Procesin e Integritetit, Sektori per Bashkepunimin Nderkufitar, eshte emeruar si Koordinator per Komponentin II te IPA-s.

Koordinatori per Komponentin II te IPA-s eshte pika kryesore e kontaktit ndermjet secilit vend perfitues dhe Komisionit per te gjitha ceshtjet qe lidhen me pjesemarrjen e vendit respektiv ne programet nen Komponentin IPA CBC.

1.2 Strukturat operacionale

Zbatimi i Programit nderkufitar do te arrihet nepermjet nje Strukture Operacionale (SO) (Neni 139 Rregullorja e Zbatimit IPA), e cila do te emerohet ne secilin vend. Ato jane:

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise	Shqiperia
Struktura Operacionale ne Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise eshte Ministria e Veteqeverisjes Lokale. Sapo vendi te marre akreditimin per menaxhimin e decentralizuar, Njesia Qendrore per Financim dhe Kontraktim (CFCU) do te behet gjithashtu nje pjese integrale e SO te vendit. Vec kesaj, sherbimet e NIPAC do te marrin pjese gjithashtu ne SO nen menaxhimin e decentralizuar.	SO ne Republiken e Shqiperise eshte Ministria e Integritetit European. Sapo vendi te marre akreditimin per menaxhimin e decentralizuar, Njesia Qendrore per Financim dhe Kontraktim (CFCU) do te behet gjithashtu nje pjese integrale e SO te vendit.

SO te secilit vend bashkepunojne ngushte ne programimin dhe zbatimin e programeve nderkufitare perkatese duke ngritur mekanizma te perbashketa koordinimi.

SO jane pergjegjese per zbatimin e programit ne vendin e tyre respektiv.

Strukturat Operacionale jane, nder te tjera, pergjegjese per:

- Pergatitjen e Programit Nderkufitar ne perputhje me Nenin 91 IPA te Rregullores se Zbatimit;

²⁰ Per te dy vendet qellimi eshte menaxhimi i decentralizuar. Ish Republika Jugosllave e Maqedonise eshte ne process te pergatitjes se akreditimit te strukturave menaxhuese. Ky process pritet qe te perfundoje ne 2008 dhe me pas vendi do te kaloje ne menaxhim te decentralizuar. Nje proces i ngjashem ka nisur dhe ne Shqiperi.

- Pergatitjen e amendimeve te programit per tu diskutuar ne Komitetin e Perbashket te Monitorimit (KPM);
- Emerimin e perfaqesuesve te tyre ne KPM;
- Ngritjen e Sekretariatit te Perbashket Teknik (SPT) (Neni 139.4 Rregullorja e Zbatimit IPA) dhe udheheqjen e punes se tij;
- Pergatitjen dhe zbatimin e vendimeve strategjike te KPM, aty ku eshte e nevojshme dhe me mbeshetjen e Sekretariatit te Perbashket Teknik;
- Raportimin tek NIPAC/Koordinatori per Komponent II IPA-s per te gjitha aspektet qe lidhen me implementimin e programit;
- Ngritjen e nje sistemi, duke u asistuar nga SPT, per mbledhjen e informacionit te besueshem mbi implementimin e programit dhe ti jape te dhena KPM, Koordinatorit te Komponentit II IPA-s dhe Komisionit;
- Sigurimin e cilesise se zbatimit te programit nderkufitar bashke me Komitetin e Perbashket te Monitorimit;
- Sigurimin e monitorimit te angazhimeve dhe pagesave ne nivel programi;
- Sigurimin qe perfituesit e grantit perdorin rregulla te pershtatshme per raportim financiar (monitorim) dhe menaxhim financiar te mire (kontroll);
- Dergimin tek Komisionit dhe tek koordinatori respektive kombetare IPA e raportit vjetor dhe ate final per zbatimin e programit nderkufitar, pas kontrollit te tij nga Komiteti i Perbashket i Monitorimit;
- Promovimin e aktiviteteve informuese dhe publicitare;

Nen menaxhimin e decentralizuar, tenderimi, kontraktimi dhe pagesat do te jene gjithashtu pergjegjesi e Strukturave Operacionale. Nen menaxhimin e centralizuar, keto jane pergjegjesi e Delegacionit te Komisionit Europian (Autoriteti Kontraktues).

1.3 Komiteti i perbashket i monitorimit

Brenda tre muajsh nga hyrja ne fuqi e marreveshjes financiare qe lidhet me programin, vendet perfituese do te ngrene Komitetin e Perbashket te Monitorimit (KPM), sipas Nenit 142 te Rregullores se Zbatimit IPA.

KPM eshte autoriteti vendimmarres i programit nderkufitar, dhe perbehet nga perfaqesues te nivelit kombetar, rajonal dhe lokal te vendeve perfituese, duke perfshire perfaqesues te Strukturave Operacionale dhe te aktoreve socio-economike ne zonen perfituese. Komisioni Europian do te marre pjese ne punen e KPM me nje rol keshillues.

KPM duhet te takohet te pakten dy here ne vit me iniciativen e vendeve pjesemarrese ose te Komisionit dhe drejtohet me rotacion nga nje perfaqesues i nje prej vendeve pjesemarrese.

Ne takimin e tij te pare, Komiteti i Perbashket i Monitorimit duhet te hartoje Rregullat proceduriale, dhe ti aprovoje ato me qellim qe te ushtroje misionet e tij ne perputhje me Rregulloren e Zbatimit IPA.

Pergjegjesite e Komitetit te Perbashket te Monitorimit

Pergjegjesite e Komitetit te Perbashket te Monitorimit jane, nder te tjera, si ne vijim:

- Vezhgon programimin dhe zbatimin efektiv te programit;
- Konsideron dhe aprovon kriteret per perzgjedhjen e projekteve te financuara nga programi nderkufitar dhe aprovon cdo ndryshim te ketyre kriterave ne perputhje me nevojat e programit;
- Ai do te rishikojte periodikisht progresin e bere drejt arritjes se objektivave specifike dhe cilesore te programit ne baze te dokumentave te derguara nga Strukturat Operacionale;
- Ai duhet te kontrollloje rezultatet e zbatimit, ne vecanti arritjen e qelimeve e caktuara per cdo aks prioritar dhe vleresimet te referuara ne Nenin 57(4) dhe Nenin 141 te Rregullores se Zbatimit IPA;

- Ai duhet te kontrollloje raportet vjetore dhe finale te zbatimit perpara dergimit te tyre tek Strukturat Operacionale, NIPAC respektive dhe Komisionit (Neni 144 Rregullorja e Zbatimit IPA)

- Ai do te jete pergjegjes per perzgjedhjen e projekteve. Per kete qellim, aty ku shihet e nevojshme (dhe duke u bazuar ne rast pas rasti), ai mund t'ia delegoje kete funksion nje Komiteti Drejtues (per te kryer rolin e nje Komiteti Vleresimi) anetaret e te cilit duhet te caktohen nga Strukturat Operacionale. Perberja e Komitetit Drejtues duhet te miratohet nga Delegacionet e

Komisionit European;

- Ai mund te propozoje cdo rishikim apo ndryshim te programit nderkufitar per te bere te mundur arritjen e objektivat te referuara ne Nenin 86(2) Rregullorja e Zbatimit IPA ose te permiresoje menaxhimin e tij, duke perfshire permiresimin e tij financiar;

- Ai duhet te konsideroje dhe aprovoje cdo propozim per te amenduar permbajtjen e programit nderkufitar;

- Ai duhet te miratoje kuadrin per detyrat e Sekretariatit te Perbashket Teknik.

1.4 Sekretariati i perbashket teknik

Sipas Nenit 139 (4) te Rregullores se Zbatimit IPA, Strukturat Operacionale duhet te ngrejne nje Sekretariat te Perbashket Teknik (SPT) per te asistuar KPM dhe SO ne permbushjen e detyrave te tyre. Pershkrimi i punes se anetare te SPT, si dhe Rregullat e detajuara te Procedurave te SPT do te hartohen bashkarisht nga SO te te dy vendeve.

SPT menaxhohet bashkarisht nga Strukturat Operacionale te te dy vendeve.

Vendndodhja e SPT eshte ne Struge, Ish Republika Jugosllave e Maqedonise. Ai do te kete nje antene ne Elbasan, Shqiperi.

SPT eshte nje stukture administrative e programit pergjegjese per menaxhimin e perditshem te tij dhe administrimin e mbarevajtjes se tij. Kostot per Sekretariatit e Perbashket Teknik dhe antenen e tij jane bashkefinancuar nga buxheti i Asistences Teknike te programit nese ato lidhen me detyra te pranueshme per bashkefinancim ne perputhje me rregullat e BE-se.

SPT perbehet nga punonjes nga te dyja anet e kufirit duke patur keshtu aftesi te ndryshme gjuhesore dhe njohuri specifike/ne drejtim te caktuar. Stafi duhet te kontraktohet nga SO respektive.

Detyrat e SPT dhe antenes se tij

SPT do te jete pergjegjes nder te tjera per detyrat e meposhtme:

- Mbeshtetje per KPM dhe Strukturave Operacionale ne zbatimin e programit

- Ai duhet te kryeje nje funksion sekretariati per Strukturat Operacionale dhe Komitetin e Perbashket te Monitorimit, duke perfshire pergatitjen dhe postimin e dokumentacionit per takimet dhe hartimin e minutave te takimeve (ne dy gjuhe ose me shume, nese kerkohet);

- Te ngreje, te mirembaje dhe te rifreskoje sistemin e monitorimit (futjen e te dhenave ne nivel programi dhe projekti);

- Te pergatise dhe te beje te aksesueshem te gjitha dokumentat e nevojshme per zbatimin e projekteve (informacionin e pergjithshem ne nivel programi, informacionin e pergjithshem ne nivel projekti, udhezimet, kriteret, aplikimet per mbledhjen e projekt-ideve, udhezimet per paketen e aplikimit, kriteret per perzgjedhjen e projekteve, lejueshmerine, format e raportimit, kontratat);

- Te zhvilloje fushata informuese, trajnime, sesione udhezuese, te krijoje rubriken “Pyetje dhe pergjigje” ne faqen e internetit, me qellim mbeshtetjen e aplikanteve te mundshem ne pergatitjen e projekt-propozimeve;

- Ai duhet te asistojte perfituesit e mundshem ne kerkimin e partnereve dhe percaktimin e projektit;

- Ai duhet te asistojte KPM dhe Komitetin e Perbashket Drejtues ne organizimin e perzgjedhjes dhe vleresimit te project propozimeve dhe te kontrolloje nese eshte i disponueshem i gjithe informacioni per marrjen e nje vendimi mbi nje projekt propozim;

- Ai duhet te menaxhoje procesin e lancimit te Thirrjeve per projekt-propozime, duke perfshire marrjen dhe regjistrimin e project aplikimeve, vleresimin fillestar (p.sh. kontrollin e dokumentave te aplikimit per plotshmerine dhe perputhshmerine e tyre me kriteret e paracaktuara) dhe pergatitjen e dokumentacionit per procesin e vleresimit;

- Te sigurohet qe i gjithe dokumentacioni i rendesishem i nevojshem per kontraktim i eshte vene ne dispozicion Delegacionit te Komisionit European ne kohe;

- Ai duhet te pergatise forma te standartizuara per aplikim per projekt-propozimi, vleresim, kontraktim, zbatim, monitorim dhe raportim te bazuar ne formate dhe modele te perfshira ne PRAG;

- Ai duhet te organizoje dhe menaxhoje nje data base ad-hoc te programit, ne baze te informacionit te mbledhur direkt gjate procesit te lancimit te Ftesës per projekt- propozime dhe informacionit te vene ne dispozicion rregullisht nga SO;

- Te organizoje aktivite te perbashketa informative dhe reklamuese nen udhezimet e KPM

dhe Strukturave Operacionale, duke perfshire ketu krijimin dhe mirembajtjen e nje faqe interneti zyrtare te programit;

- Te pergatise, te udheheqe dhe te raportoje monitorimin e projekteve;
- Te kontribuojne ne dhenien e informacioneve per hartimin e raporteve perfundimtare mbi programin nder-kufitar;
- Ai duhet te planifikoje aktivitetet e tij ne perputhje me planin e punes vjetor te aprovuar nga KPM.

1.5 Autoritetet kontraktuese

Ne te dy vendet, Autoriteteti Kontraktues do te jete Komisioni European.

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonise	Shqiperia
Delegacioni i Komisionit European Marsal Tito 12, 1000 Shkup Tel: (+389 2) 3122 032 Fax: (+389 2) 3126 213	Delegacioni i Komisionit European Rruga e Duresit 127-1, Laprake-Tirane Tel: (+355 4) 228 320 / 228 479 Fax: (+355 4) 230 752

Ne te dy vendet, ne perputhje me Nenin 140(1) Rregullores se Zbatimit IPA, Komisioni European mban pergjegjesi te pergjithshme per vleresimin ex ante per thirrjet per projekt propozime, dhenien e granteve, tenderimin, kontraktimin dhe kryerjen e pagesave.

Autoritetet Kontraktuese jane pergjegjese, nder te tjera, dhe per:

- Aprovimin e dokumentacionit per thirrje per projekt propozime;
- Aprovimin e perberjes se Komitetit te Perbashket Drejtues;
- Aprovimin e raporteve vleresuese dhe listes se projekteve;
- Te jene te pranishem ne Komitetin e Perbashket te Monitorimit me nje rol vezhgues;
- Nenshkrimin e kontratave me perfituesit e granteve, duke perfshire rishikimin e buxhetit (aty ku eshte e arsyeshme me mbeshtetjen e Strukturave Operacionale dhe SPT);

1.6 Perfituesit e programit

Perkufizimi i perfituesve udheheqes dhe perfituesve te tjere

Ne perputhje ne Nenin 96(3) te Rregullores se Zbatimit IPA, nese jane disa perfitues finale te nje aktivitetit ne secilin vend perfitues, ata duhet te caktojne nje perfitues udheheqes ndermjet tyre perpara dergimit te projekt propozimit. Perfituesi udheheqes duhet te marre persiper pergjegjesite e lidhura me zbatimin e projektit te percaktuara me poshte.

Pergjegjesite e Perfituesit Udheheqes dhe te Perfituesve te tjere

Pergjegjesite e Perfituesve Udheheqes

Ne perputhje me rregullat e Nenit 96(3) te Rregullores se Zbatimit IPA, perfituesi udheheqes duhet te marre persiper pergjegjesite e meposhtme per pjesen e projektit qe zhvillohet ne vendin respektiv:

- Ai duhet te percaktojne ne nje marreveshje rregullat per marredheniet e tij me perfituesit te fundit qe marrin pjese ne projektin qe zhvillohet ne vendin respektiv, nder te tjera, rregulla qe garantojne menaxhimin financiar te mire te fondeve te alokuara per kete projekt, duke perfshire ketu dhe rregulla per kthimin e shumave te paguara padrejtesisht.

- Ai do te jete pergjegjes per sigurimin e zbatimit te pjeses se projektit qe zhvillohet ne vendin respektiv;

- Ai do te jete pergjegjes per transferimin e kontributit te Komunitetit drejt perfituesve te fundit qe marrin pjese ne ate pjese te projektit qe zhvillohet ne vendin respektiv;

- Ai duhet te sigurohet qe shpenzimet e prezantuara nga perfituesit qe marrin pjese ne ate pjese te projektit qe zhvillohet ne vendin respektiv jane paguar per qelimin e zbatimit te projektit dhe korrespondjne me aktivitetet e rena dakort ndermjet perfituesve te fundit qe marrin pjese ne projekt.

Perfituesit udheheqes nga vendet pjesemarrese duhet te kene nje koordinim te ngushte ndermjet tyre ne zbatimin e projektit.

Pergjegjesite e perfituesve te tjere

Cdo perfitues pjesemarres ne nje projekt do te:

- Marre pjese ne projekt;
- Te jete pergjegjes per sigurimin e zbatimit te aktiviteve nen pergjegjesine e tij ne perputhje me planin e projektit dhe marreveshjen e nenshkruar me perfituesin udheheqes;
- Te bashkepunoje me perfitues partnere te tjere ne zbatimin e projektit, ne raportim dhe ne monitorim;
- Te jape informacionin e kerkuar per audit dhe nga strukturat e auditit pergjegjese per te;
- Te marre pergjegjesi ne rast te ndonje parregullsie ne shpenzime qe jane deklaruar, duke perfshire ripagime te mundshme ndaj Komisionit;
- Te jete pergjegjes per masat informuese dhe komunikuese per publikun.

Partneri Udheheqes Funksional

Ne rast te projekteve te perbashketa (kur Partneret Udheheqes nga te dyja anet jane pjesemarres dhe jane kontraktuar ne vecanti nga Autoritetete Kontraktuese te Shqiperise dhe te Maqedonise) dy Perfituesit Udheheqes duhet te caktojne ndermjet tyre nje Partneri Udheheqes Funksional perpara per dergimin e projekt propozimit.

Partneri Udheheqes Funksional eshte:

- Pergjegjes per koordinimin e pergjithshem te aktiviteve te projektit ne te dyja anet e kufirit;
- Pergjegjes per organizimin e takimeve te perbashketa te partnereve te projektit;
- Pergjegjes per raportimin ne SPT te progresit te pergjithshem te projektit te perbashket.

2. Rregullat e zbatimit

2.1 Rregullat themelore te zbatimit

Programi Nderkufitar financon projekte te perbashketa te cilat jane perzgjedhur bashkarisht nga vendet perfituese nepermjet nje Ftese per projekt propozime te vetme e cila mbulon te gjithe zonen perfituese.

Projektet e perzgjedhura duhet te perfshijne perfituesit finale nga te dy vendet te cilet do te bashkepunojne te pakten ne nje nga menyrat e meposhtme: zhvillim i perbashket, zbatimi i perbashket, stafi i perbashket dhe financim i perbashket (Neni 95 Rregullorja e Zbatimit IPA).

KPM eshte pergjegjes per perzgjedhjen e projekteve.

Autoriteti Kontraktues eshte pergjegjes per dhenien e granteve nepermjet kontratave si dhe per kontrollat ex-ante te proceseve te dhenieve te granteve.

2.2 Procesi i dhenies se grantit

Procesi i dhenies se granteve duhet te jete ne perputhje me rregullat e Rregullores se Zbatimit IPA (p.sh. Nenet 95, 96, 140, 145, etj.)

Aty ku eshte e pershtatshme, duhet te ndiqen procedurat PRAG dhe format dhe modelet standarte nese rregullat e Rregullores se Zbatimit IPA dhe/ose natyra e perbashket e ftesave kane nevoje per ndryshime.

a) Pergatitja e paketes se aplikimit

- SPT, nen vezhgimin e KPM, harton nje Ftese te vetme per projekt propozime, Udhezimet per aplikantet dhe formen e aplikimit dhe dokumenta te tjere qe lidhen me zbatimin e skemave te granteve, duke shpjeguar rregullat ne lidhje me lejueshmerine e aplikanteve dhe partnereve, tipin e aksioneve dhe kostove, te cilat jane te lejueshme per financim dhe kriteret e vleresimit duke ndjekur sa me shume te jete e mundur formatet e parashikuara ne PRAG.

- Forma e Aplikimit duhet te mbuloje te dyja pjeset e projektit, por me nje ndarje te qarte te aktiviteve dhe kostove ne secilen ane te kufirit. Elementet perberes te Paketes se Aplikimit (lejueshmeria dhe kriteret e vleresimit etj.) duhet te jene plotesisht ne perputhje me Marreveshjen Financiare perkatese.

- Sapo ato te miratohen nga KPM, Strukturat Operacionale respektive, i dergojne per miratim Delegacionit te Komisionit European: Ftesa per projekt propozime, Udhezimet per aplikuesit dhe anekset e tij.

b) Publikimi i nje Ftese te vetme per propozime

- Kur shpallet Ftesa per propozime, Strukturat Operacionale, me asistencen e SPT, marrin te gjitha masat e pershtatshme per te siguruar qe ftesa per propozime arrin grupet e percaktuara ne perputhje me kerkesat e Udhezuesit Praktik (PRAG) Paketa e aplikimit eshte e aksesueshme ne faqen

e internetit të programit dhe në faqet e internetit të Delegacioneve të Komisionit Europian (Autoriteti Kontraktues) dhe në një kopje të printuar.

- SPT është përgjegjës për fushatën informuese dhe dhenien e përgjigjeve ndaj pyetjeve të aplikanteve të mundshëm. SPT ofron keshillim për aplikantët e mundshëm në lidhje me kuptimin dhe formulimin e formës së sakta të aplikimit.

- Pyetjet dhe përgjigjet duhet të jenë të aksesueshme si në faqen e internetit të programit dhe në ato të Delegacionit të Komisionit Europian

c) Përzgjedhja e projekteve

Ashtu siç parashikohet në Rregulloren e Zbatimit IPA, projekt propozimet e dërguara do të nënshtrohen një procesi përzgjedhjeje të përbashkët. Procesi i vlerësimit duhet të ndjekë rregullat PRAG (Kapitulli 6.4) si është amenduar nga dispozitat e Rregullores së Zbatimit IPA. (p.sh. Neni 140 mbi rolin e Komisionit në përzgjedhjen e projekteve)²¹. Një Komitet i Përbashkët Drejtues, i caktuar nga KPM, do të vlerësojë projektet në përputhje me kriteret e përcaktuara në Paketën e Aplikimit dhe do të hartojë një listë rreshtore në përputhje me PRAG. Në bazë të saj, Komiteti i Përbashkët i Monitorimit do të marrë vendimin përfundimtar mbi projektet për tu rekomanduara për financim tek Autoritetet Kontraktuese (Delegacionet e Komisionit Europian).

Hapat kryesore të procedurës duhet të jenë si mëposhtë:

- Projekt propozimet e ardhura mbledhen dhe regjistrohen nga SPT

- KPM është përgjegjës për vlerësimin e projekt propozimeve në përputhje me kriteret e lejueshmërisë; megjithatë, kur ai e sheh të nevojshme, ai mund të caktojë një Komitet të Përbashkët Drejtues për vlerësimin e përputhshmërisë administrative, lejueshmërisë dhe vlerësimin e cilësive teknike dhe financiare të propozimeve.

- Anëtarët e Komitetit të Përbashkët të Drejtimit caktohen vetëm në bazë të ekspertizës teknike dhe profesionale në fushën përkatëse. Delegacionet e Komisionit Europian miratojnë përberjen e Komitetit të Përbashkët të Drejtimit. Një vëzhgues i caktuar nga Delegacioni i Komisionit Europian mund të marrë pjesë në procedurat e tij.

- Komiteti i Përbashkët i Drejtimit vlerëson projektet përkundërt kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Thirrjen për projekt propozime-Paketa e Aplikimit dhe në përputhje me procedurat PRAG.

- KPM merr nga Komiteti i Përbashkët i Drejtimit Raportin e Vlerësimit me propozimet e vlersuara dhe ia transmeton ato, me rekomandime, siç duhet, Delegacioneve të Komisionit Europian nëpërmjet Strukturës Operacionale të vendeve respektive.

- Nëse kerkohet, KPM mund të kërkojë sqarime nga Komiteti i Përbashkët i Drejtimit. Në rast mosmarrëveshjeje mbi përfundimet e Raportit të Vlerësimit, ose nëse KPM kërkon të devijojë rezultatet e Komitetit të Përbashkët të Drejtimit, ai duhet të shprehë shqetësimet e tij, në letren e tij të rekomandimit/aprovimit drejtuar Delegacionit të Komisionit Europian. Megjithatë, KPM nuk ka të drejtë në asnjë rreth të ndryshojë pikët ose rekomandimet e Komitetit të Përbashkët të Drejtimit dhe nuk duhet të ndryshojë tabelat e vlerësimit të plotësuar nga vlerësuesit.

- Delegacionet e Komisionit Europian aprovjnë Raportin e Vlerësimit mbi procesin e vlerësimit dhe listën përfundimtare të granteve që do të jepen. Delegacionet e Komisionit Europian mund të kërkojnë nga KPM sqarime.

- SPT njofton me shkrim çdo aplikant për rezultatin e procesit të përzgjedhjes.

- Delegacioni i Komisionit Europian në secilin vend lidh kontratën e grantit me përfituesin udhëheqës respektiv të secilit projekt të përzgjedhur.

2.3 Bashkefinancimi dhe lejueshmëria e shpenzimeve

Kontributi i Komunitetit për programet nderkufitare në nivel të akteve prioritarë nuk e kalon kufirin e 85% të shpenzimit të lejueshëm (shpenzimeve publike ose të shpenzimeve në total).

²¹ Rregullorja e Zbatimit IPA për Komponentin II parashikon, *nder të tjera*, njëfarë niveli për decentralizimin në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes, që do të thotë se në vendet përfituese ku fondet IPA menaxhohen në mënyrë të centralizuar (p.sh. ku komiteti i vlerësimit është i caktuar nga autoritetet kombëtare që marrin pjesë në KPM, jo nga Komisioni i.e. the Autoriteti Kontraktues).

Kontributi i Komunitetit per cdo aks prioritar nuk eshte me i vogel se 20% i shpenzimit te lejueshem.

Ne te dy vendet shpenzimi i lejueshem bazohet ne shpenzimin total sic referohet ne Nenin 90 te Rregullores se Zbatimit IPA. Kontributi kombetar do te sigurohet nga perfituesit e fundit dhe ai mund te jete nga fondet publike si dhe nga fondet private.

Ne nivel aktiviteti, lejueshmeria e shpenzimeve eshte ne perputhje me Nenet 89 dhe 34.3 90 te Rregullores se Zbatimit IPA.

3. Informimi, publiciteti dhe konsultimi

Vendet perfituese dhe Koordinatorët Kombetare IPA duhet te japin informacion dhe te publikojne programin dhe aktivitetet e tij me asistencen e SPT, sic eshte e pershtatshme.

Ne perputhje me Nenin 90 te Rregullors (EC, Euratom) Nr. 1605/2002, Komisioni duhet te publikoje informacionin lidhur me kontratat. Komisioni duhet te publikoje rezultatet e procedurave te tenderit ne Fletoren Zyrtare te Bashkimit European, ne faqen e internetit EuropeAid dhe ne cdo media tjeter te pershtatshme, ne perputhje me procedurat kontraktuale te aplikueshme per operacionet e jashtme te Komunitetit.

Masat informuese dhe publikuese prezantohen ne forme te nje plani komunikimi, permes te cilit zbatimi eshte pergjegjesi e Struktures Operacionale respektive dhe Koordinatorëve te Komponentit II IPA. Plani i detajuar i informacionit dhe publicitetit do ti prezantohet KPM ne nje forme te strukturuar nga SPT, duke prezantuar ne menyre te qarte qellimet dhe grupet e qellimit, permbajtjen dhe strategjine e masave dhe nje buxhet indikativ te financur nga buxheti i Asistences Teknike Assistance te programit nderkufitar.

Masat e vecanta te informimit dhe publicitetit do te fokusohen kryesisht ne:

- Sigurimin e nje shperndarje te gjere te programit nderkufitar (te perkthyer ne gjuhen lokale) ndermjet aktoreve dhe perfituesve potenciale;

- Sigurimin e materialeve publicitare, organizimin e seminareve dhe konferencave, njoftimet per median dhe drejtimin e nje web site te programit per te rritur ndergjegjesimin, interesin dhe per te inkurajuar pjesemarrjen;

- Sigurimin e publicitetit me te mire te mundshem per ftesat per projekt propozime.

- Publikimin e listes se perfituesve te fundit.

SPT ne bashkepunim me KPM do te hartoje nje strategji te pergjithshme per informimin dhe publicitetin per zbatimin e programit dhe do te hartoje nje sistem te pergjithshem per marredheniet me publikun ne lidhje me programin;

- Te formoje dhe mirembaje faqen e internetit;

- Te vazhdoje marredheniet e nevojshme me publikun dhe komunikimet me median;

- Te perhape materialet informuese dhe publicitare;

- Te organizoje seminare per hartimin e projekteve te perbashketa dhe konferenca;

- Te perfshije perfaqesuesit e Komisionit European ne informim dhe publicitet;

- Te caktoj nje person pergjegjes per informimin dhe publicitetin.

4. Menaxhimi financiar

Nen menaxhimin e centralizuar, Komisioni European do te merret me te gjitha detyrat qe kane te bejne me tenderimet, kontraktimet dhe pagesat, ne baze te dokumentave te dhena nga perfituesi, dhe ne perputhje me rregullat e kontraktimit dhe prokurimit per percaktuara ne "Udhezuesin Praktik per Proceurat Kontraktuale per operacionet e jashtme te KE" (PRAG).

Komiteti i Perbashket i Monitorimit duhet te siguroje qe ekziston nje sistem i besueshem i kompjuterizuar financiar, monitorimi dhe raportimi financiar per te siguruar nje seri auditimesh te pershtatshme.

Komisioni European dhe autoritetet kombetare te auditit do te kene pushtetin e auditit mbi programin nderkufitar.

5. Monitorimi dhe vleresimi

5.1 Monitorimi

Perfituesit Udheheqes i dergojne Autoriteteve Kontraktuese respektive nje Raport narrativ te Ndermjetem dhe nje Raport Final ne perputhje me rregullat standarte te kontratave te tyre te grantit.

Vec kesaj, nese eshte e rendesishme, Partneri Udheheqes Funksional i projektit i dergon SPT

Raporte, duke i dhene nje informacion mbi aktivitetet e projektit dhe arritjet e tij ne te dyja anet e kufirit dhe koordinimit te tyre sipas indikatoreve te percaktuar ne projekt propozimin e perbashket.

Duke u bazuar ne progres raportet e projektit te marra, SPT harton Raportin e Zbatimit te Perbashket dhe ia dergon ate per kontroll KPM.

5.2 Vleresimi i programit

Vlersimet duhet te kryhen ne perputhje me Nenin 141 te Rregullores se Zbatimit IPA. Vleresimi duhet te kete per qellim te rrise cilesine, efektivitetin dhe vazhdimesine e asistences nga fondet e Komunitetit dhe te strategjise per zbatimin e programve nderkufitare duke marre parasysh objektivin e zhvillimit te qendrueshem dhe legjislacionin perkates te Komunitetit ne lidhje me ndikimin ne ambjent.

Nje vlersimim ex-ante nuk eshte kryer ende ne perputhje me Nenin 141 nga pikepamja e principit te proporcionalitetit.

Gjate periudhes se programimit, vendet pjesemarrese dhe/ose Komisioni European duhet te kryeje vlersime te lidhura me monitorimin e programit nderkufitar ne vecanti kur monitorim nxjerr ne pah nje shmangie te rendesishme nga qellimet e percaktuara fillimisht ose kur propozimet jane bere per rishikimin e programit nderkufitar. Rezultatet duhet ti dergohen Komitetit te Perbashket te Monitorimit te programit nderkufitar dhe Komisionit.

Vlersimet duhet te kryhen nga eksperte ose struktura, te brendshme ose te jashtme. Rezultatet duhet te publikohen ne perputhje me rregullat e aplikueshme per aksesin ne dokumentacion. Vleresimi do te financohet nga buxheti i asistences teknike te programit.

6. Raportimi

Strukturat Operacionale te vendeve perfituese duhet ti dergojne Komisionit dhe Koordinatorëve respektive IPA nje raport vjetor dhe nje raport final mbi zbatimin e programit nderkufitar pas kontrollit te tij nga Komiteti i Perbashket i Monitorimit.

Raporti vjetor duhet te dergohet cdo vit deri ne 30 Qershor, dhe heren e pare ne vitin e dyte qe pason miratimin e programit nderkufitar.

Raporti final duhet te dergohet jo me vone se 6 muaj pas mbylljes se programit nderkufitar.

Permbajtja e raporteve duhet te jete ne perputhje me kerkesat e Nenit 144 te Rregullores se Zbatimit IPA.